

UNITED NATIONS
United Nations
Interim
Administration
Missionin Kosovo



NATIONS UNIES
Mission
d'Administration
Intérimaire des Nations
Unies au Kosovo

KUVENDI I KOSOVËS СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

BULETINI

Maj, 2006 Nr.12

DEPUTETËT MIRATOJNË NDRYSHIME NË KREUN E KUVENDIT DHE VOTOJNË QEVERINË E RE TË KOSOVËS

Kolë Berisha - kryetar i Kuvendit, Agim Çeku-kryeministër



DEBATI PARLAMENTAR MBI TAKIMET E VJENËS

Integriteti territorial i Kosovës dhe karakteri unitar i saj janë të pacenueshëm

Shefi i UNMIK-ut vlerëson fillimin e mbarë të Berishës në krye të legjislativit

*Të përshpejtohet miratimi i legjislacionit,
por edhe shpallja e ligjeve që kanë të bëjnë
me plotësimin e standardeve
Petersen optimist se në qershor do të ketë
arsye të raportojë për përparime të duk-
shme në Kosovë*



Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kolë Berisha, ka pritur sot Përfaqësuesin Special të Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së në Kosovë, Soren Jessen-Petersen dhe ka biseduar me të për punët që i presin institucionet e Kosovës deri në përfundimin e bisedimeve për përcaktimin e statusit të vendit.

Kryeparlamentari Berisha në këtë takim miqësor është fokusuar në nevojën e ngutshme të miratimit të ligjeve, që kanë të bëjnë me plotësimin e standardeve dhe ka kërkuar nga zotëri Petersen që të përshpejtohet çështja e nënshkrimit dhe e shpalljes së një grumbulli ligjesh që janë miratuar nga Kuvendi i Kosovës dhe të cilat lidhen me plotësimin e standardeve për Kosovën.

Shefi i UNMIK-ut, Petersen, ka shprehur konsideratat e tij për ndryshimet pozitive që ka sjellë kryeparlamentari Berisha në krye të legjislativit, duke theksuar se ky nuk është vlerësim vetëm i tij, por edhe i përfaqësuesve të tjerë ndërkombëtar në Kosovë, madje edhe i vetë Grupit të Kontaktit. Ai është shprehur i kënaqur me dinamikën e punëve të Kuvendit dhe të Qeverisë së Kosovës dhe ka shfaqur bindjen e tij se në qershor do të ketë arsye të raportojë para Këshillit të Sigurimit të OKB-së, për përparime të dukshme në Kosovë.

Petersen, ndërkaq, ka pohuar se sheh një sinjoret të institucioneve për arritje të rezultateve pozitive, por ka tërhequr vëmendjen se nevojiten sidomos përparime në terren dhe në veprime.



PËRMBAJTTJA:

Angazhim për thellimin e bashkëpunimit ndërparlamentar ndërmjet Gjermanisë e Kosovës 10

Auditimi gjen përkrahje në të gjitha komunat..... 11

Pakti i Stabilitetit i interesuar për demokratizimin e shoqërisë dhe të institucioneve të Kosovës 12

Disa nene të Ligjit mbi Prokurimin Publik në Kosovë sjellin pengesa gjatë zbatimit në praktikë..... 13

Kornizë adekuate ligjore në funksion të zhvillimit të komunikacionit rrugor14

Redaksia:

Sherif Konjufca, Shefqet Rexhepi, Celal Ilyas, Edona Fetahu

Telefonat Kontaktues:

038\ 211 186, 038\ 211 949, 038\ 211 189, 044\ 127 921

Tel/Fax: **038 211 188**

E-mail:

media@assembly-kosova.org

Eeb faqja:

www.assembly-kosova.org

Kolë Berisha - kryetar i Kuvendit, Agim Çeku-kryeministër

Në seancën e jashtëzakonshme të Kuvendit të Kosovës të 10 marsit , të drejtuar nga deputeti Naim Maloku, kryetar i ri i Kuvendit të Kosovës është zgjedhur deputeti, Kolë Berisha, i cili do të jetë edhe anëtar i Kryesisë, ndërsa deputeti, Sabri Hamiti, anëtar të kësaj Kryesie. Berisha dhe Hamiti, zëvendësojnë Nexhat Dacin dhe Fatmir Sejdiun, i cili kohë më parë është zgjedhur kryetar i Kosovës.



Fillimisht arsyetimin për këto ndryshime në kreun e Kuvendit të Kosovës e ka paraqitur kryetari i Grupit parlamentar të LDK-së, Alush Gashi, kurse pastaj për këtë çështje janë shprehur edhe shefat e partive opozitare të PDK-së dhe ORA- s , zotërinjtë Thaçi dhe Surroi, si dhe

shefat e grupeve parlamentare.

Naim Maloku, anëtar i Kryesisë, në fillim theksoi se në pajtim me kreun 9, pika 1,7 dhe 9 pika 1 dhe 8 të Kornizës Kushtetuese, si dhe të rregullave 4 dhe 5 të Rregullores së punës,Grupi Parlamentar i LDK-së i

është drejtuar Kuvendit me propozimin për zëvendësimin e anëtarit të Kryesisë dhe kryetarit të Kuvendit të Kosovës, z. Nexhat Daci me z. Kolë Berisha,deputet i Kuvendit të Kosovës, si dhe të z. Fatmir Sejdiu me z. Sabri Hamiti, për anëtar të Kryesisë së Kuvendit. Propozimi u

është shpërndarë të gjithë deputetëve.

Në vijim, shefi i Grupit Parlamentar të LDK-së, Alush Gashi, tha se ky grup parlamentar me mbështetje unanime propozon zëvendësimin e z. Nexhat Daci, kryetar i Kuvendit të Kosovës me z. Kolë Berisha, deputet dhe nënkryetar i Lidhjes Demokratike të Kosovës, si dhe propozon zotëri Sabri Hamitin, deputet nga radhët e Lidhjes Demokratike të Kosovës, për anëtar të Kryesisë së Kuvendit të Kosovës, pasi z. Fatmir Sejdiu, anëtar i Kryesisë së Kuvendit të Kosovës, është zgjedhur kryetar i Kosovës dhe me vullnetin e tij ka dhënë dorëheqje nga pozita e anëtarit të Kuvendit të Kosovës.

Alush Gashi njoftoi kryesuesin dhe të pranishmit se që nga 9 marsi 2006 Ali Sadriu është deputet dhe anëtar i Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës.

Pastaj fjalën e mori z. **Jakup Krasniqi**, shefi i Grupit Parlamentar të PDK-së, i cili tha se ne e respektojmë vullnetin e partisë më të madhe parlamentare, por jemi të detyruar si grup parlamentar ta bëjmë një pyetje. I përmendi disa pika dhe nene kryesuesi, por në Rregulloren e punës së këtij kuvendi në kreun e tretë, ku bëhet fjalë për Kryesinë, rregulla 5 pika 3 shkruan: “Kryetari i Kuvendit mund t’i paraqesë dorëheqjen Kuvendit, aktin e dorëheqjes me shkrim ia dorëzon paraprakisht Kryesisë së Kuvendit. Pas miratimit të dorëheqjes partia politike ose koalicioni që e ka emëruar ish-kryetarin e Kuvendit propozon kandidatin për kryetar në pajtim me rregullën 4 të kësaj Rregulloreje”. Rregulla 5 pika 5 shkruan: “Shkarkimi i kryetarit të Kuvendit, ose i anëtarit të Kryesisë së Kuvendit, me propozim të partisë politike, ose të grupit që e ka emëruar, bëhet sipas procedurës së zgjedhjes së tyre”. Në këtë rast dëshirojmë ta respektojmë Rregulloren e punës së Kuvendit, apo dëshirojmë ta tejkalojmë këtë

rregullore që e kemi miratuar në këtë kuvend.

Naim Maloku tha se pika e dytë e rendit të ditës, që është në shqyrtim tani, është zëvendësimi i anëtarit të Kryesisë dhe kryetar i Kuvendit të Kosovës, z. Nexhat Daci me z. Kolë Berisha, pra nuk bëhet fjalë për shkarkim, por për zëvendësimin e dy anëtarëve të Kryesisë që janë nga grupi parlamentar më i madh. Në vijim me shumicë votash deputetët votuan pro propozimit të Grupit Parlamentar të LDK-së.

Tempull i vërtetë i demokracisë parlamentare

Pas zgjedhjes kryesuesi ia dha fjalën kryetarit të ri të Kuvendit të Kosovës, **Kolë Berisha**, i cili theksoi: “Jam i vetëdijshëm se duke më dhënë besimin që prej sot t’i organizoj, t’i mbikëqyr dhe t’i koordinoj dhe drejtoj punimet dhe aktivitete e tjera nga fushëveprimi i këtij parlamenti, në fakt me votën tuaj më keni ngarkuar me një obligim të madh, me një detyrë që kërkon mund, përgjegjësi dhe sakrificë. Kosova ndodhet në muajt dhe në ditët vendimtare, do të thosha edhe para orëve të saj, po ashtu vendimtare. Ne tash kemi hyrë në një fazë gjithësi historike për Kosovën, për institucionet e saj të dala nga vota e lirë e qytetarëve, popullin - vullnetin e të cilit ne së bashku, por edhe me ndihmën e miqve tanë të shumtë të prirë nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe vendet e Bashkimit Evropian, duhet ta çojmë deri në fund, deri në krijimin e një shteti të pavarur dhe sovran, që do të jetë shembull në këtë pjesë të Evropës Juglindore, të një shteti që do t’i bashkëngjitet Evropës demokratike, por gjithësi të një shteti që do të jetë në miqësi të përhershme me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, aleatin tonë më të madh, që dy herë vetëm brenda një shekulli, në çastet më të vështira, u gjend afër nesh. Para këtij Kuvendi, si njëri ndër mekanizmat më të rëndësishëm, në

mos më i rëndësishmi për bërjen e Kosovës shtet të pavarur dhe sovran, shtrohen detyra shumë të mëdha, prandaj në këto momente nëpër të cilat po kalojmë edhe mbi partinë time të madhe dhe mbi partitë tuaja pak a shumë më të vogla në numër, është diçka shumë më e madhe, shumë më e shtrenjtë, diçka që duhet të jetë mbipartiake, mbipersonale, mbigrupore, mbikonfesionale e mbigjinore, është kauza jonë e përbashkët dhe e përgjithshme-Kosova shtet sovran dhe i pavarur, e tanishmja dhe e ardhmja e fëmijëve tanë dhe e fëmijëve të fëmijëve tanë. Ju garantoj se me tërë qenien time do të angazhohem që kjo shtëpi e shenjtë, prej nga dolën dhe do të dalin aktet që përcaktojnë, rregullojnë dhe sanksionojnë sistemin politik, juridik, ekonomik dhe fushat e tjera të jetës në shtetin e Kosovës, të jetë vërtet tempull i demokracisë parlamentare, të jetë tempull i fjalës së lirë të deputetit, të jetë zë i fuqishëm i pozitës dhe i opozitës, i shumicës dhe i pakicës, pra të drejtat e barabarta të të gjithë qytetarëve të Kosovës pa dallim etnie, politike, gjinie, feje etj. Do të angazhohem që deputeti të ndihet zot i vërtetë i kësaj shtëpie. Mua do të më duhet ndihma juaj dhe ju garantoj se do ta keni ndihmën time.

Duke qenë njeriu i parë ndër të barabartit në këtë shtëpi, krahas përpjekjeve të pandërprera për krijimin e kushteve më të mira për punë normale dhe për zgjidhjen e problemeve eventuale të secilit deputet veç e veç dhe të të gjithëve së bashku, natyrisht për aq sa lejojnë rrethanat aktuale, do të angazhohem maksimalisht që në Kryesinë e Kuvendit, përmes grupeve parlamentare, të komisioneve dhe trupave të tjerë të Kuvendit të Kosovës, të thellohet edhe më shumë ajo që për mua është më e rëndësishmja. Do të thosha kushte thelbësore për arritjen e këtyre synimeve janë: toleranca, mirëkuptimi dhe bashkëpunimi, sepse vetëm kështu mendoj se duhet të shkojmë përpara. Unë mendoj se rruga më e mirë për t’i arritur këta

dhe objektivat e tjerë, është zbatimi me përpikëri i Kushtetutës, i ligjeve dhe i akteve të tjera nënligjore, duke përfshirë këtu në radhë të parë Rregulloren e këtij kuvendi. Popujt e civilizuar udhëhiqen nga normat e shkruara dhe ne do të dimë të dëshmojmë se jemi të tillë”.

Kolë Berisha pastaj falënderoi kryetarin e deritashëm të Kuvendit të Kosovës, akademik Nexhat Dacin ,për punën dhe kontributin e dhënë në udhëheqjen e këtij institucioni në çastet më të vështira për Kosovën dhe për popullin e saj.

Falënderoj, tha ai , partinë time - LDK-në, për besimin e dhënë. Lehtë nuk do ta kemi, por bashkërisht do t'ia dalim. Jam i bindur se miqtë tanë në radhë të parë ata nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Evropa, do të na ndihmojnë, ashtu si na kanë ndihmuar deri më sot. Amerika dhe Evropa janë këtu për të na ndihmuar që edhe ne të bëhemi pjesë e këtij civilizimi. I garantojmë miqtë tanë se ky është edhe qëllim ynë i përhershëm.

Në vijim të seancës kryetari i Kosovës, **Fatmir Sejdiu** , para deputetëve paraqiti propozimin e kandidati për kryeministër të Kosovës. z. Agim Çeku.

Pas kësaj **Agim Çeku** paraqiti listën e kabinetit qeveritar.

Në bazë të Kornizës Kushtetuese të Kosovës, tha Çeku, dhe të mandatit të dhënë nga presidenti i Kosovës , pas konsultimeve të nevojshme me partnerët e koalicionit qeveritar, më lejoni ta prezantoj kabinetin e Qeverisë së Kosovës.

Z. Lutfi Haziri, zëvendëskryeministër i Kosovës dhe ministër i administrimit i pushtetit lokal.

Z. Haki Shatri, ministër i Ekonomisë dhe Financave,

Z. Fatmir Rexhepi, ministër i Punëve të Brendshme,

Z. Jonuz Salihaj, ministër i Drejtësisë,

Zonjusha Melihate Tërmkolli, ministre e Shërbimeve Publike,

Z. Ethem Çeku, ministër i Energjisë dhe i Minierave,

Z. Agim Veliu, ministër i Arsimit, Shkencës dhe i Teknologjisë,

Z. Slavisha Petkoviç, ministër i Kthimit dhe i Komuniteteve,

Z. Sadik Idriz, ministër i Shëndetësisë,

Z. Bujar Dugolli, ministër i Tregtisë dhe i Industrisë,

Z. Qemajl Ahmeti, ministër i Transportit dhe i Telekomunikacionit,

Z. Adrian Gjini, ministër i Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor,

Z. Ibrahim Selmanaj, ministër i Punës dhe i Mirëqenies Sociale,

Z. Astrit Haraqia, ministër i Kulturës, Sportit dhe i Çështjeve

Rezidente,

Z. Tomë Hajdaraj, zëvendësmministër i Bujqësisë, Pylltarisë dhe i Zhvillimit Rural,

Z. Aziz Zila, zëvendësmministër i Pushtetit Lokal,

Z. Behxhet Brajshori, zëvendësmministër i Ekonomisë dhe i Financave,

Z. Blerim Kuçi, zëvendësmministër i Punëve të Brendshme,

Z. Dejan Jankoviç, zëvendësmministër i dytë i Punëve të Brendshme,

Z. Mark Komoni, zëvendësmministër i Shërbimeve Publike,

Z. Sylë Hoxha, zëvendësmministër i Drejtësisë,

Z. Agron Dida, zëvendësmministër i Energjisë dhe i Minierave,

Z. Fevzi Berisha, zëvendësmministër i Arsimit Shkencës dhe i Teknologjisë,

Z. Nazmi Fejza dhe z. Ibush Bajrami, zëvendësmministra për Kthim dhe Komunitete,

Z. Fadil Kryeziu zëvendësmministër i Shëndetësisë,

Z. Kadri Kryeziu, zëvendësmministër i Tregtisë dhe i Industrisë,

Z. Blerim Baruti, zëvendësmministër i Transportit dhe i Komunikacionit,

Z. Merxhan Abdyli, zëvendësmministër i Ambientit dhe i Planifikimit Hapësinor,

Z. Lulzim Leci, zëvendësmministër i Punës dhe i Çështjes Sociale,

Zonja Anxhelina Krasniqi dhe z. Eugen Koruglu zëvendësmministra të Kulturës, Sportit dhe të Çështjeve

Jorezidente.

E vërejtët se vendi i ministrit të

Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural dhe ai zëvendësmministrit të Pushtetit Lokal, janë të paplotësuar, sepse sipas Kornizës Kushtetuese janë të rezervuara për Listën Serbe, gjithashtu zëvendësmministri i Drejtësisë është vend i rezervuar për Partinë Demokratike Turke. Partnerët e koalicionit ende nuk janë të gatshëm të propozojnë emra, por në afat të shkurtër kanë premtuar se do t'i propozojnë emrat për këto vende në kabinetin qeveritar.

Kam pranuar këtë përbërje të Qeverisë të Kosovës, me një marrëveshje të nënshkruar, me partnerët e koalicionit që në një afat kohor do të vlerësohet puna e çdo ministri të Qeverisë së Kosovës dhe në rast vlerësimi negativ do të kërkohet zëvendësimi i ministrit me kandidat tjetër, tha Agim Çeku .

Duke ftuar për votimin e këtij kabineti të Qeverisë, Çeku u zotua se besimi i deputetëve do të shfrytëzohet për të punuar në të mirën e gjithë qytetarëve të Kosovës, duke bërë tërë atë që kërkohet nga ne dhe për t'i çuar përpara proceset drejt bërjes së Kosovës shtet të pavarur dhe sovran.

Po tentohet të ndodhë rilegjitimi i së keqes së madhe

Pas paraqitjes së listës fjalën e mori **Hashim Thaçi** i cili theksoi se Kosova është futur në procesin e vendimeve të mëdha politike dhe të zhvillimit serioz të botës së vet pluraliste. Zakonisht, ndërrimet dhe ndryshimet në politikë janë të nevojshme kur gjërat nuk ecin mirë, por ato duhet të kryhen brenda rregullave të demokracisë dhe sipas bazës kushtetuese të një vendi.

Pa dëshirën time dhe të Partisë Demokratike të Kosovës edhe sot dua të ripërsëris faktin se, që në fillim të formimit të këtij koalicioni qeveritar, kemi shprehur shqetësimin tonë politik dhe qytetar, me argumente, si shqetësim dhe rrezik ndaj demokracisë, sigurisë, të ardhmes së statusit politik të vendit

dhe të mirëqenies qytetare të kosovarëve. Një vit resht Kosova u qeveris në mënyrën më të keqe të mundshme. Korrupsioni s'ka të ndalur, aferat, keqpërdorimet u bënë emblema e Qeverisë së koalicionit aktual. Faktet, faktorët dhe aktorët e kësaj së keqeje të Kosovës të ofruara nga opozita demokratike u kuptuan drejt nga opinioni i gjerë publik, nga shoqëria civile, nga pjesa e mendimit të avancuar demokratik të koalicionit aktual, ato u prezantuan drejt nga shumica e mediave dhe tani po vërtetohen gradualisht edhe nga drejtësia vendore dhe ajo ndërkombëtare. Si rezultat i kësaj keqqeverisjeje sot Kosova është edhe më e varfër, pasiguria sociale është rritur, zhvillimi ekonomik ka shënuar rënie. Privatizimi si proces është privatizuar nga qeveritarët aktualë, papunësia është rritur, mirëqenia e qytetarëve është në rënie të vazhdueshme.

Në Qeverinë aktuale nuk po ndodhin ndryshime, por po ndodhin ndërrime të imponuara nga politika. U largua i pari i Qeverisë, vullnetshëm me trafikim politik dhe erdhi tjetri. I pari i Qeverisë ka qenë e keqja më e vogël e Qeverisë aktuale. E keqja e madhe ka mbetur, është këtu, udhëheqës i së cilës në muajt e ardhshëm vullnetshëm do të jetë mandatar i parapolitikës, i prapaskenës së politikës kosovare. Sot në Kuvendin e Kosovës po tentohet të ndodhë me vetëdije të plotë rilegjitimimi i së keqes së madhe.

Mbështetje për Qeverinë e re

Gjylnaze Syla, shefe e Grupit Parlamentar të AAK-së duke uruar Kolë Berishën për postin e ri ofroi edhe bashkëpunimin më të ngushtë të subjektit që përfaqëson. Të luftojmë për të treguar pjekuri politike, unitet për një qëllim të përbashkët në një kohë kaq të rëndësishme dhe të votojmë për Qeverinë e re, theksoi ajo.

Alush Gashi, shef i Grupit Parlamentar të LDK-së theksoi se

mbështet propozimin e bazuar në Kornizën Kushtetuese të ekselencës së tij kryetarit të Kosovës për mandatar të Qeverisë së re dhe tërë listën e tij në krye me z. Agim Çeku. Njëkohësisht rikonfirmojmë se si pozitë do të jemi shumë të hapur dhe transparentë, të bëjmë përpjekje maksimale për mbikëqyrjen parlamentare të organeve të Qeverisë.

Ai i kundërshtoi akuzat që vinin në adresë të mandatarit dhe të listës së propozuar për Qeveri. Gashi ftoi edhe deputetët e opozitës që t' i bashkëngjiten Grupit Parlamentar të LDK-së për zgjedhjen e Qeverisë së re, që është një nga shenjat e shëndetit dhe të zhvillimit të institucioneve demokratike të Kosovës nga institucionet e përkohshme vetëqeverisëse në institucionet e përhershme.

Pse ndodhën këto ndryshime të rrufeshme

Jakup Krasniqi, shefi i Grupit Parlamentar të PDK-së theksoi se koha, ky gjykatës i pagabueshëm, i verifikoi një për një vërejtjet dhe konstatimet e Grupit Parlamentar të PDK-së, të ngritura që nga seanca e parë e kësaj legjislatore, të thëna e të argumentuara në seancat në vazhdim për koalicionin qeveritar dhe për institucionet që më vonë dolën prej tij.

Koalicionit, vetëqeverisjes e veprimtarisë së ushtruar në vazhdimësi, nuk mund t' u përshkruhet asnjë sukses. Këtë e tregojnë edhe zhvillimet e fundit për funksionet më vitale, siç janë ekzekutivi dhe legjislativi i Kosovës, që përveç tjerash kanë dëmtuar shumë edhe unitetin e popullit, në kohën kur vendit dhe qytetarëve u duhet uniteti në vepër për njohjen ndërkombëtare të shtetit të pavarur dhe sovran të Kosovës.

Koalicioni do të duhej t'u tregonte Kuvendit e të gjithë qytetarëve të Kosovës pse ndodhën këto ndryshime të rrufeshme, a po bëhen për ndryshime cilësore për dobi të

vendit apo për rirreshtime brenda grupeve të interesit në parti të koalicionit. Cilat janë arsyet e këtyre ndryshimeve të ngutshme? Koalicioni duhet të tregojë pse edhe për të tretën herë kërkon legjitimitimin e krimit, të korrupsionit me të njëjtat figura. Ne jemi të bindur se kohë më parë është dashur të ndodhin këso ndryshimesh, por jo kështu tinëzisht, por duke i numëruar të gjitha faktet dhe dëshmitë për shkelje të ligjeve dhe për keqqeverisje të tjera të mjeteve financiare të tatimpaguesve të Kosovës së varfër, që po prodhon sundimtarë të fuqishëm, sundimtarë që nuk po i nënshtrohen ligjit në fuqi, por sundimtarë që bëjnë ligje sipas tekeve të veta. Ata, në vend që të përgjigjeshin para drejtësisë, po largohen me biografi avancuese për ngritje pozicionesh në të ardhmen, për rokada shahu. As institucionet e as qytetarët e Kosovës nuk kanë nevojë për to, por kërkojnë ndryshime më të thella e përmbytjesore që i duhen vendit.

Kabineti Kosumi nuk ishte i dobët pse udhëhiqej nga Bajram Kosumi, por pse Bajram Kosumi kishte trashëguar një kabinet të dobët, të përbërë nga ministrat e inkriminuar që vinin nga bota e krimit të organizuar. Ky koalicion, nëse kihet parasysh mënyra si ka qeverisur deri më tani, nuk mund të ofrojë qeverisje të mirë që i duhet Kosovës dhe qytetarëve të saj.

Deputeti **Veton Surroi**, shef i Partisë Reformiste Ora theksoi se kjo qeveri që po na premtohet, ose po kërkon voten tonë, nuk e ka hartuar një program, nuk ka program të ri, ndërsa nuk e ka përmendur as të vjetrin, që na ofrohet, është një kontratë gojore që ekziston në gojëdhëna, ekziston në format e shitblerjes së tokave në shekujt XVII, XVIII dhe XIX, por jo edhe në qeverisje. Mungesa e kontratës dhe mungesa e programit janë mungesë e fjalës, në popull i thonë se i kanë hëngërfjalët e veta. Ajo çka po ndodh sot, këtu në këtë Kuvend, është krijimi i një qeverie të re me shantazh, se duhet të mbeten të gjithë këta minis-

tra , përndryshe u kërcënohen partive të tyre, me shantazh se duhet të mbeten sepse partitë nuk kanë njerëz më të mirë, se duhet të mbeten për hir të stabilitetit të Kosovës. Kosova, të gjithë ne, ky parlament dhe të gjitha partitë politike kanë dhënë ditë pas dite, dhe posaçërisht në momentet dramatike provimin e tyre për stabilitet, pse i frikohemi stabilitetit dhe jostabilitetit. Kjo qeveri do të hyjë , për fat të keq, qoftë si propozim, qoftë si akt i mbyllur në histori, si qeveri e shantazhit.

Çdo zgjedhje e çdo vendim në jetë janë matje e argumenteve dhe kjo që ne e bëjmë sot është të matim në peshoren tonë të ndërgjegjes politike, morale etj. Interesi i përbërjes së kësaj qeverie është ky, tash këtu. Cili është interesi i përbërjes së kësaj qeverie nëse nuk ka program politik. Cili është ai program qeverisës, cili është interesi i kësaj qeverie nëse nuk ndërrohen shumica e ministrave të saj të dëshmuar për jo efektivitet ose jo përbushje të detyrave në punë? Interesi i vetëm zonja dhe zotërinj është të qenia në pushtet, është të qenët në Qeveri. Nëse kjo është e vërtetë, atëherë interesi i vetëm i të qenët në pushtet është gëzimi i beneficioneve që i krijon ai pushtet, dhe nëse kjo është e vërtetë, këto beneficione për fat të keq në muajt e fundit ose në vitet e fundit, të gjithë ne si kosovarë kemi qenë si dëshmitar se janë beneficione jologjore, jashtë ligjore, jashtë institucionale, që kanë të bëjnë prej veturave të shtrenjta e deri te formimi i fondeve paralele, qoftë individuale, qoftë partiake.

Kosova këtë vit, për herë të parë, do të hyjë me deficit buxhetor të projektuar. Deficiti buxhetor i projektuar që mund të ketë qenë 50 milionë € në fund të vitit të kaluar, arrin në 70 deri në 100 milionë € për këtë vit. Nëse është kjo e vërtetë, nëse trendi ekonomik tregon se në fund të këtij viti do të kemi deficit buxhetorë prej 100 milionë €, kjo është goditja dhe mesazhi i drejtpërdrejt i qytetarëve të

Kosovës, kjo është mesazh për arsimtarin, është mesazh për punëtorin e shëndetësisë, për policin, për të gjithë ata që shfrytëzojnë buxhetin.

Duke folur në emër të Grupit 6 + z. **Xhezair Murati** theksoi se, duke i vërejtur sfidat para të cilave gjendemi të gjithë , përkrahim fillimin e rikonstruktimit të Qeverisë, i përshëndesim ndryshimet, i falënderojmë të gjithë ata që kanë kuptuar se kanë pasur lëshime të caktuara , vështirësi të caktuara , të cilët sot nuk janë në mes nesh e që ishin deri dje . Pra, është njerëzore të mos e harrojmë ndihmesën e secilit prej nesh. Është njerëzore të japim vërejtje dhe të ketë lëshime , por unë këtu dua të them se sigurisht, edhe në të ardhmen, asnjë vend ministror në këtë Qeveri nuk do të jetë i çimentuar. Askush nuk ka mandat që, krahas gabimeve eventuale , të mbetet atje ku nuk duhet të mbetet. Mendojmë se do të vijmë në shprehje aftësitë udhëheqëse dhe organizuese të mandatarit të ri.

Ferid Agani theksoi se Grupi Parlamentar për Integrim shpreh gatishmëri për bashkëpunim konstruktiv në përparimin e mëtutjeshëm të proceseve demokratike në Kuvendin e Kosovës. Grupi Parlamentar për Integrim ka qenë i përgatitur që sot të votojë për kabinetin e ri qeveritar, në bazë të një programi të mirëfilltë qeveritar, që do të japë përgjigje për problemet e shumta të grumbulluara në shoqërinë tonë. Për fat të keq kjo nuk ndodhi. Grupi Parlamentar për Integrim konsideron se serioziteti i çështjes dhe fakti se vendoset për personalitete politike, imponon nevojën të merret vendimi në këtë Kuvend për votim të fshehtë, në kuti votimi. Këtë mundësi e parasheh rregulla 18 pika 3 e Rregullores së Punës së Kuvendit të Kosovës.

Votimi i fshehtë do të paraqiste garantin më të mirë për realizimin e vlerave demokratike në Kuvend. Me gjithë respektin e madh për kryetarin e Kosovës dhe për mandatarin e

Qeverisë së Kosovës ,njoftoj Kuvendin se në rast se për kabinetin qeveritar vendoset pa shqyrtimin paraprak të programit të Qeverisë së re dhe në rast se për këtë kabinet të ri vendoset pa votim të fshehtë, Grupi Parlamentar për Integrim do të përmbahet nga votimi.

Teuta Sahatqiu, shefe e Grupit Parlamentar ORA, theksoi se dorëheqja e kryeministrit Kosumi, ishte akt i imponuar me qëllim të inicimit të ndryshimeve pozitive, duke menduar se me këtë dorëheqje do të hapej rruga për krijimin e një qeverie të re me njerëz të rinj, me njerëz që do të kenë fuqi ta udhëheqin Kosovën në procesin negociator deri në pavarësinë e saj, por si u pa i vetmi ndryshim ishte vetëm heqja e kryeministrit dhe e zëvendëskryeministrit dhe vendosja e një njeriu të ri , emri i të cilit nuk është lakuar me afëra dhe vendosjen e tij në një rreth të vjetër, në rreth të dëshmuar si të dështuar. Në këtë qeveri të re janë të njëjtit njerëz të vjetër, të cilëve iu deshën 50 ditë për ta hapur për qarkullim rrugën kryesore që mbush buxhetin e varfër të Kosovës, rrugë që ushqen Kosovën, i siguron rrogat e arsimtarëve, shëndetësisë, policëve, zjarrfikësve dhe të gjithë atyre që marrin rrogë nga buxheti.

Gjergj Dedaj theksoi se nëse një personalitet, një faktor, një kandidat që dëshiron të kandidohet për t' u zgjedhur në një forum, në një trup, në një mekanizëm, siç është rasti tash në krye të Qeverisë së Kosovës, paraprakisht duhet atij trupi që e voton, që e zgjedh, atij elektorati t'ia paraqet një program, se çka do të bëjë për të gjitha këto probleme të grumbulluara për të cilat është debatuar edhe sot dhe që janë evidente në qeverinë aktuale të Kosovës. Ne nuk dimë për asnjë pikë dhe nuk na është ofruar asgjë nga mandatarin, z. Çeku, për të cilin kemi shumë respekt, se çka do të bëjë me këto probleme, ndaj në këtë mënyrë neve na ka vënë në një sprovë që ka qenë plotësisht e panevojshme.

Etiketat bëjnë efekt të kundërt

Fetah Berisha shprehu mendimin se është rendi që të kalohet në votim sipas rendit të ditës, sepse nuk mund t'i japim z Çeku leksione, sepse për të tek tash duhet të votojmë. Kemi kohë për ta vlerësuar edhe Qeverinë që do ta votojmë tash, por edhe të kaluarën.

Mark Krasniqi tha se kudo në botë parlamentet janë shpeshherë jo parlamente, por edhe hajt park, ku mund të flitet gjithçka, madje edhe mirë edhe me vend, por edhe keq dhe jo me shumë vend. Këtu konkretisht akuzohet një mandatar i Qeverisë për karrierizëm, ka ardhur këtu që të bëjë karrierizëm. Unë nuk di se ku i kanë sytë njerëzit. Deri dje e kemi parë me shumë nishana, gjeneral, e sot jemi si unë e si ai, pa asnjë nishan. Me ardhjen e z Çeku këtu në Kuvend, Qeveri, njerëzit po e akuzojnë se e ka lëshuar frontin ku e ka pasur vendin. Gjenerali është gjithmonë edhe strateg. Ai e lëshon një front për të shkuar në frontin tjetër ku është lufta më e ashpër. Kështu ka bërë edhe zotëri Çeku këtu, sepse sot është lufta për Kosovën, nuk është lufta për karrika. Z. Çeku e uroj për këtë guxim që e ka pasur të vijë këtu.

Nekibe Kelmendi tha se qeverinë, nuk e ka mandatin ta bëjë opozita, por pozita, prandaj i mbetet opozitës ta votojë, ose të mos e votojë këtë Qeveri, kjo është çështja e saj, por unë ju lus që së paku të kemi një respektim të kodit të mirësjelljes dhe ta kursejmë atë nga fyerjet, nga shpifjet, nga fjalimet boshe, pa asnjë fjalë pozitive, e deri dje çdo kush ka folur në superlativ për të (fjalën e ka për Agim Çekun).

Sabri Hamiti theksoi se po flitet këtu edhe me humor, po flitet edhe arsyeshëm, po flitet edhe me brengë, që tregon se situatat në këtë parlament, edhe ato serioze mund të jenë shumëgjyrëshe.

Ne e kemi një ushtarak i cili po hyn në botën e civilizimit, botën civile të

politikës dhe kjo është e vërtetë. Unë dëgjova këto ditë disa breshni fjalës rreth Agim Çekut që më duken krejt të ngjashme me ato që janë thënë për Haradinajn për afërsisht. Është e drejtë e opozitës dhe e gjithkujt që të shprehë mendimet e veta, po është problemi që duhet kujdesen njerëzit a janë të besueshëm, sepse është problem të bëhet njeri publikisht i besueshëm nëse figurat e veta emblematike me të cilat krenohet, përnjëherë thotë nuk vyejnë gjë, por kjo është problem që të mendojnë për këtë kush i thotë.

Në anën tjetër unë dëgjova këtu kualifikimet që erdhën nga dy anëtarët, t'i quaj krahet të opozitës me formulime të forta, do t'i quaja unë, më shumë etiketa se sa karakterizime, u tha që kjo ose ajo, pa u përcaktuar, Qeveria e krimit dhe Qeveria e shantazhit. Shikoni, këto janë kualifikime shumë të rënda dhe shumë të forta dhe kur jepen pa analiza nuk janë tjetër veçse etiketa në parlament, që është shtëpia më e fortë e të folurit dhe dokumentimit të të folurit. Etiketat nuk thonë gjë, unë po ju garantoj që bile bëjnë efekt të kundërt, sepse më shumë mbulojnë se sa zbulojnë. Përkundër kësaj, unë mendoj që ky parlament që sot, por edhe më herët, sidomos që sot, merr përgjegjësi të jashtëzakonshme për Qeverinë që do të mandatojë. Unë thërras që ky Parlament ta ushtrojë këtë detyrë me analiza, me përcjellje të punës, të njerëzve që mandatohen, të thuhet haptas që nuk e synon Qeveria Parlamentin, por Parlamenti është ai që e mandaton dhe e kontrollon Qeverinë, kjo është esenciale dhe funksioni i këtij Parlamenti do të vijë në vend, atëherë kur e merr fuqinë çdo dy javë, a çdo muaj, qysh të mblidhet, të thërras në përgjegjësi ministrat, ose Qeverinë e plotë, të japë përgjegjësi për punën e bërë.

Pas mori fund debati, Kolë Berisha ftoi deputetët të hyjnë në fazën e votimit. Së pari ai nxori në votim propozimin e grupeve parlamentare për integrim dhe ORA, në pajtim me

rregullin 18, pika 3 të Rregullores së punës për mundësinë e votimit të fshehtë, duke kërkuar që Kuvendi të deklarohet për mënyrën e votimit për zgjedhjen e Qeverisë.

Për propozim të fshehtë votuan 39 deputetët, 64 ishin kundër, ndërsa një abstenoj, ndaj nuk kaloi propozimi për votim të fshehtë.

Në vazhdim u votua për kabinetin e ri qeveritar, për zgjedhjen e të cilit 65 deputetë ishin për, 33 kundër, ndërsa 5 veta abstenuan. Me këtë edhe u zgjodh Qeveria e re e Kosovës.

Të krijojmë ura të mirëbesimit në mes të njerëzve

Pas zgjedhjes së Qeverisë së re, fjala iu dha kryeministrit të ri të Kosovës, z. **Agim Çeku**. Pasi theksoi se këtë detyrë po e merr ndoshta në kohën më të vështirë dhe më vendimtare, Agim Çeku tha se në këto momente kyçe për Kosovën dhe për popullin e saj, besimi i juaj do të jetë pikëmbështetje e punës sime në udhëheqjen e Qeverisë së Kosovës. Me marrjen e kësaj përgjegjësie, ne ju themi juve dhe qytetarëve të Kosovës se qeverisja jonë do të jetë e bazuar në mirëqenien e qytetarit të Kosovës, pavarësisht dallimeve etnike, fetare apo politike. Synimet tona të përbashkëta do t'i realizojmë në bashkëpunim me të gjithë ju dhe me miqtë tanë ndërkombëtarë.

Parimet e qeverisë të cilën do ta drejtoj burojnë nga programi qeveritar. Do të përqendrohemi në forcimin e mëtejshëm të institucioneve, punësimin dhe përmirësimin e kushteve ekonomike të qytetarëve të Kosovës, forcimin e stabilitetit politik dhe të sigurisë, përmirësimin e qeverisjes dhe kuadrit ligjor, si dhe dinamizmin e punës rreth përmirësimit të standardeve, me qëllim të krijimit të rrethanave sa më të volitshme për njohjen e pavarësisë së Kosovës në një kohë sa më të shpejtë. Ndonëse gjendemi në fazën kryesore të procesit të krijimit të shtetit të Kosovës, synimet tona nuk

përfundojnë me kaq. Ne kemi ende për të bërë drejt realizimit të aspiratave tona.

Ne duam një Kosovë demokratike dhe tolerante, të integruar në strukturat e Bashkimit Evropian dhe në NATO. Ne duam një Kosovë që është burim i stabilitetit në Rajon dhe katalizator i zhvillimeve pozitive në këtë pjesë të Evropës. Krijimi i shtetit të Kosovës është vullneti i popullit të Kosovës, ashtu siç është edhe i qeverisë kosovare.

Ne do të punojmë që të krijojmë ura të mirëbesimit në mes të njerëzve të Kosovës dhe do të arrijmë që dallimet ndëretnike t'i shndërrojmë në vlera të shoqërisë sonë. Qeveria e Kosovës do të kultivojë klimën e mirëbesimit dhe të bashkëpunimit të ndërsjellë, me qëllimin më të mirë që Kosova të jetë shtëpi e të gjithë qytetarëve të saj.

Koha e urrejtjes, diskriminimit dhe vuajtjeve për qytetarët e Kosovës duhet t' i takojë së kaluarës. Ka ardhur koha e pajtimit ndëretnik e integritimeve dhe prosperitetit të gjithmbarshëm.

Një gjë është e qartë për të gjithë. Nuk ka liri të plotë në Kosovë përderisa të gjithë qytetarët e Kosovës nuk e gëzojnë atë.

Popullata shumicë e Kosovës, ne shqiptarët, duhet të dimë se çelësi i realizimit të synimeve të shumicës në Kosovë është mirëqenia dhe respekti për popullatën pakicë.

Andaj, kujdesi ndaj pakicave është interes i shumicës. Komunitetet pakicë në Kosovë duhet të besojnë se interesat e tyre do të avancohen dhe do të mbrohen në Kosovën që ne sot po e ndërtojmë, andaj bashkëpunimi i ngushtë dhe konstruktiv i tyre shpejton këtë proces të rëndësishëm për ardhmërinë e Kosovës.

Komuniteti Serb i Kosovës duhet të besoj se shoqëria që po e ndërtojmë do të mbështetet në parimet më të larta njerëzore të tolerancës dhe mirëbesimit. Për krijimin e Kosovës vend demokratik dhe prosperues implementimi i standardeve është një nga lokomotivat e rëndësishme

që shpejton këtë proces, andaj dinamizimi i punës për implementimin e standardeve do të zërë një vend të rëndësishëm në agjendën tonë qeverisëse.

Që nga ditët e ardhshme do të fillojmë me aktivitete të ngjeshura për implementimin e standardeve. Dhe jo pse këtë na ka vënë kusht bashkësia ndërkombëtare, por për shkak se me përmbushjen e tyre i ndihmojmë vetes.

Ju sigurojmë se vlerësimet nga bashkësia ndërkombëtare, por edhe nga qytetarët e Kosovës do të reflektojnë angazhimet tona, veprimet tona dhe si të tilla, ato do të jenë pozitive. Përmbushja e standardeve do të jetë argumenti ynë më i fortë në bisedimet për statusin e Kosovës.

Furnizimi me rrymë vazhdon të jetë një problem i madh, me gjithë investimet e mëdha që janë bërë. Infrastruktura e Kosovës ende vuan nga mungesa e cilësisë, kurse arsimit dhe shëndetësia janë në një gjendje e cila kërkon shqyrtim serioz nga të gjithë ne. Duhet ta ruajmë dinjitetin e pensionistëve, mësimmësuesve, mjekëve, ushtarëve dhe policëve tanë. Qeveria do të krijojë politika adekuate ekonomike dhe legjislacionin e nevojshëm, që të tërheqë investimet në industri, biznes dhe në arsimimin e njerëzve, sipas nevojave ekonomike të vendit. Ne duhet ta shfrytëzojmë pozitën tonë gjeografike dhe resurset tona natyrore dhe njerëzore që t'u ofrojmë investitorëve të huaj mundësi tërheqëse për investime.

Pavarësisht se edhe pas statusit do të ketë prezencë të NATO-s në Kosovë, që para se gjithash është vullneti i qytetarëve të Kosovës, ne do të punojmë me përkushtim për të ndërtuar sistemin tonë të sigurisë, përfshirë edhe forcën mbrojtëse të Kosovës. Këtë do ta bëjmë në partneritet të plotë me NATO-n dhe miqtë ndërkombëtarë.

Një kujdes të veçantë do të tregojmë për ruajtjen dhe avancimin e vlerave të mëdha të luftës. Unë për asnjë çast nuk do të harroj se prej nga vij, sepse ai që nuk e di se prej nga vjen,

nuk e di se ku do të shkojë. Unë jam krenar se kam qenë luftëtar i UÇK-së dhe ushtar i komandantit legjendar Adem Jashari. Çdo ditë të punës sime si kryeministër do ta filloj duke pasur në mendje këto vlera të shenjta për të gjithë qytetarët e Kosovës.

Përkujdesja për kategoritë e dala nga lufta: familjet e dëshmorëve, të rënëve për lirinë e Kosovës, invalidët dhe veteranët e luftës, zbardhja e fatit të të zhdukurve do të jenë në fokus të angazhimit tim. Ne u jemi shumë borxhli këtyre kategorive, të cilat meritojnë kujdes më të madh nga të gjithë. Sa më shumë që po afrohet statusi i Kosovës, aq më i madh bëhet borxhi ndaj tyre.

Shumë shpejt Kosovës do t'i jepet mundësia e pjesëmarrjes në ngjarje kulturore dhe sportive ndërkombëtare. Andaj ne një kujdes të veçantë do t'i kushtojmë kulturës, sportit dhe artit.

Gjithashtu edhe diaspora do të zërë vend të merituar në programin e Qeverisë sonë dhe në punën tonë të përditshme.

Me qeverinë që do të kryesoj nuk fillon asgjë nga e para. Ne do ta vazhdojmë kontinuitetin e qeverive para nesh dhe do të përpiqemi me të gjitha forcat për ta dinamizuar dhe bërë sa me efikase këtë Qeveri. Dëshiroj të falënderoj me këtë rast të gjithë kryeministrat para meje: z. Bajram Rexhepin, z. Ramush Haradinaj dhe z. Bajram Kosumi, por edhe Presidentin e ndjerë Ibrahim Rugova dhe kryetarin e deritashëm të asamblesë, akademik Nexhat Dacin, të cilët kanë krijuar një bazë të mirë qeverisjeje, mbi të cilën mund të mbështetem gjatë punës sime.

Ne jemi brezi më me fat në historinë e Kosovës. Ne na zgjodhi historia për ta sjellë lirinë në Kosovë bashkë me miqtë tanë. Këtu nuk ka asgjë të falur, çdo gjë është arritur me sakrificën e shumë brezave të popullit tonë. Jemi para fitores përfundimtare. Pas sakrificave nuk ka asgjë më të kotë se sa ngarendja për të përvetësuar fitore. Fitorja është e Kosovës, e popullit dhe e qytetarëve të saj.

Mbështetje e Zyrës Amerikane për kreun e legjislativit të vendit dhe për procesin nëpër të cilin po kalon Kosova

Kreu i ri i Kuvendit premtan se do të jetë i sinqertë dhe bashkëpunues me bashkësinë ndërkombëtare, sidomos me SHBA-të

Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kolë Berisha, në ditën e tij të parë të punës në funksionin me përgjegjësi në të cilin është zgjedhur, ka pritur shefin e Zyrës Amerikane në Kosovë, Phillip Goldberg dhe ka këmbyer me te pikëpamje për zhvillimet më të reja në Kosovë dhe për perspektivat e procesit të cilin po e kalon vendi.

Kryeparlamentari Bertisha e ka vlerësuar shumë të rëndësishme mbështetjen e SHBA-ve për Kosovën dhe është shprehur i lumtur që me përfaqësuesin amerikan takohet që në ditën e parë të punës në kreun e Kuvendit.

Shefi i Zyrës Amerikane në Kosovë, Phillip Goldberg duke i dhënë mbështetje kryetarit të porsazgjedhur të Kuvendit të Kosovës, është shprehur se dyert e zyrës së tij do të jenë përherë të hapura për te e për miqtë të tjerë në institucionet e Kosovës.



Zotëri Berisha u ka deklaruar gazetarëve se takimi me diplomatin amerikan gjithsesi ishte më shumë se promovues, sepse në te shprehet mbështetja për Kosovën dhe për procesin politik dhe demokratik të vendit. Ai ka premtuar se do të jetë i sinqertë

dhe bashkëpunues me bashkësinë ndërkombëtare, sidomos me SHBA-të. Do të jemi bashkë, sidomos, për sa i përket bisedimeve për statusin e Kosovës, ka thënë kryeparlamentari Berisha në takim me shefin e Zyrës Amerikane, Phillip Goldberg.

Angazhim për thellimin e bashkëpunimit ndërparlamentar ndërmjet Gjermanisë e Kosovës

Mirënjohje për kontributin e Gjermanisë në mbështetjen e çështjes së Kosovës

Ekziston gatishmëri e dyanshme për thellimin e bashkëpunimit ndërmjet Parlamentit të Gjermanisë dhe atij të Kosovës, nisur nga fakti se Kosova mund të shfrytëzojë eksperiencën e Gjermanisë në segmentet e gjithmbarshme të jetës parlamentare. Bashkëpunimi duhet të vazhdojë gjithnjë, para dhe pas zgjidhjes së statusit të Kosovës. Ky ishte konstatimi thelbësor në takimin që pati kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kolë Berisha, me delegacionin gjerman, të kryesuar nga Ruprecht Polenz, kryetar i Komisionit për Punë të Jashtme të Bundestagut, i shoqëruar edhe nga shefi i Zyrës Gjermane në Prishtinë, z. Eugen Wollfarf. Në fillim të takimit kryepar-

lamentari Berisha e njohu delegacionin gjerman me zhvillimet aktuale në Kosovë, me theks të veçantë në Parlamentin e Kosovës. Në këtë vështrim Berisha foli për strukturën e Parlamentit të Kosovës, duke u ndalur posaçërisht në pjesëmarrjen e komuniteteve, sidomos të atij serb, në Parlament. Ai tha se të gjitha komunitetet janë të përfaqësuara në Parlament, madje ato në bazë të Kornizës Kushtetuese përfitojnë edhe nga aspekti i aplikimit të diskriminimit pozitiv. Këtë të drejtë e gëzon komuniteti serb, si dhe komunitetet tjera. Në vijim kryeparlamentari Berisha i shprehu falënderime delegacionit për bashkëpunimin dhe mbështetjen që Gjermania ofron për

çështjen e Kosovës. Z. Ruprecht Polenz shprehu interesimin e tij rreth përfaqësimit të pakicave në Parlament. Duke folur për këtë çështje ai u ndal më shumë në bojkotin që i bëjnë deputetët serbë punës në Parlamentin e Kosovës. Z. Polenz u angazhua për dyer të hapura ndaj deputetëve nga komuniteti serb, ndërsa propozoi që në rastin e bojkotit të ekspozohen para opinionit ulëset e zbrazëta që u takojnë këtyre deputetëve. Në këtë vështrim ai theksoi se edhe bashkësia ndërkombëtare duhet të angazhohet më shumë për të ndikuar në kthimin e deputetëve serbë në Parlament. Të gjitha këto synime kanë për qëllim që në Parlament të dëgjohet zëri i komuniteteve.

Auditimi gjen përkrahje në të gjitha komunat

Të sendërtohet bashkëpunim i afërt institucional në të gjitha segmentet që kanë për qëllim zhvillimin shoqëror e ekonomik të vendit, por edhe zbatimin e ligjeve që sjell Kuvendi i Kosovës

Kryetari i Kuvendi të Kosovës, Kolë Berisha, priti sot delegacionin e Asociacionit të Komunave të Kosovës, të cilin e përbëjnë kryetarët e komunave të vendit. Në fillim të takimit, Ismet Beqiri në emër të këtij Asociacioni, e përgëzoi kryeparlamentarin për detyrën e re. Beqiri dhe folësit tjerë, pos që e uruan kryetarin, prematuan një bashkëpunim institucional në të gjitha segmentet që kanë për qëllim zhvillimin shoqëror e ekonomik të vendit, por edhe zbatimin e ligjeve që sjell Kuvendi i Kosovës. Kryetarët e komunave theksonin se do të duhej të bëhet një praktikë që Parlamenti me rastin e hartimit dhe procedimit të ligjeve, të konsultojë edhe komunat, sepse pikërisht ato do të mbajnë mbi supë edhe çështjen e aplikimit të ligjeve në praktikë. Ky do të ishte edhe një si lloj debati publik për ligjet.

Diskutuesit vlerësuan lart klimën e debatit mjaft të frytshëm që po zhvillohet në Parlament. Me këtë rast ata përmendën edhe shumë halle me të cilat ballafaqohen në punën e përditshme për të krijuar një ambient sa më të mirë për të gjithë qyte-



tarët e vendit. Ata ishin të njëzëri se janë për zbatimin e përpiktë të ligjeve, ndaj edhe auditimi që po bëhet aktualisht, po gjen përkrahje në të gjitha komunat, sepse, si u tha këtu, ai është në funksion të eliminimit të dobësive, si i tillë ai edhe heq dilemat. Diskutuesit u angazhuan edhe për transparencë më të madhe të procesit të decentralizimit.

Duke iu drejtuar të pranishmëve, kreu i legjislativit të vendit, Kolë Berisha theksoi se pesha kryesore e aktiviteteve zhvillohet në komuna. Edhe pavarësia e Kosovës fillon në komuna, sepse komunat e zhvilluara janë faktor shumë i rëndë-

sishëm për rimëkëmbjen e vendit, pra edhe të ndërtimit të shtetit stabil, që jeton në mbështetje të resurseve të veta njerëzore e materiale. Kjo do të ishte edhe si përgjigje për zërat që pyesin se a mund të mbijetoni si shtet i pavarur. Parlamenti i Kosovës do të jetë gjithnjë i hapur dhe afër halleve me të cilat ballafaqohen komunat, sepse vetëm së bashku mund të arrihet zhvillimi më i hovshëm. Kryeparlamentari Berisha tha se kryetarët e komunave i shoh si subjekte jashtë partiake, sepse zhvillimi i komunave është përgjegjësi e të gjithëve dhe nuk mund të ketë ngjyrimë partiake.

“Trepça” nuk bën të privatizohet para se Kosova të marrë përgjegjësitë e plota

Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kolë Berisha, priti sot një delegacion të anëtarësh të Sindikatës së Minierave të Stan Tërgut, të kryesuar nga Hasan Potoku, kryetar, sindikatë kjo që në gjirin e vet ka rreth 600 minatorë. Duke rrëfyer për pozitën shumë të rëndë të minatorëve dhe të kompleksit "Trepça", delegacioni ishte i një fjale se "Trepça" asnjëherë në historinë e saj nuk ka qenë në gjendje kaq të keqe. Fajin për këtë gjendje të rëndë të këtij kolektivi me emër në Kosovë, ata ia hodhën fajin stafit menaxherial, i cili nuk është i interesuar ta çojë përpara "Trepçën".

Minatorët vazhdimisht shtronin shqetësimin se nga po shkon "Trepça". Ata posaçërisht i brengoste çështja e privatizimit të këtij kolektivi të madh. Për këtë, ata kishin qëndrim të prerë se kurrsesi nuk duhet të privatizohet "Trepça" para se Kosova të marrë përgjegjësitë e plota.

Në këto përpjekje për të mbijetuar minatorët e shihnin veten të lënë pas dore nga ana e institucioneve të Kosovës, të cilat si theksonin ata, vetëm premtojnë e nuk ndërmarrin asgjë për të ndihmuar minatorët dhe këtë kolektiv me rëndësi të madhe për Kosovën, që të tejkalojë këtë

krizë në të cilën gjendet. Mirëpo, kjo krizë nuk mund të tejkalohet me këtë staf menaxherial, ndaj ata kërkojnë që ky staf të ndërrohet.

Në pozitën e palakmueshme të minatorëve do të reflektohet edhe paralajmërimi se pensionistëve të "Trepçës" do t'iu hiqen edhe nga 10 euro nga pensionet prej 50 eurosh sa marrin deri tash. Kryeparlamentari Berisha tha se ndjen nga afër të gjitha këto halle e shqetësime të minatorëve. Ai u shpreh se në kuadër të kompetencave që ka Kuvendi do të angazhohet maksimalisht për zgjidhjen e problemeve të këtij kompleksi.

Pakti i Stabilitetit i interesuar për demokratizimin e shoqërisë dhe të institucioneve të Kosovës

Të thellohet bashkëpunimi me parlamentet e vendeve evropiane

Busek shprehet i gatshëm për të dhënë sqarime edhe para deputetëve të Kuvendit të Kosovës

Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kolë Berisha, ka pritur sot koordinatoren e Paktit të Stabilitetit të Evropës Juglindore, Erhard Busek dhe ka biseduar me të për zhvillimet në Kosovë dhe për bashkëpunimin institucioneve të Kosovës me Paktin e Stabilitetit dhe me mekanizmat tjerë evropianë.

Berisha ka falënderuar për ndihmën që Pakti i Stabilitetit i ka dhënë Kosovës me gjithë pengesat që shkakton statusi ende i pazgjidhur i

Kosovës.

Zotëri Busek ka shprehur interesimin e Paktit të Stabilitetit për demokratizimin e shoqërisë dhe të institucioneve të Kosovës, sidomos ka theksuar bashkëpunimin ndërparlamentar me vendet e Evropës në kuadër të programit "Bashkëpunimi parlamentar" dhe mitingut ndërparlamentar "KOZAK", takimi i radhës i të cilit mbahet në Vjenë, në muajin qershor. Lidhur me mundësitë e gjera të bashkëpunimit, Busek është

shprehur i gatshëm për të dhënë sqarime edhe para deputetëve të Kuvendit të Kosovës.

Duke e falënderuar për vizitën dhe përgëzimet për postin në të cilin është zgjedhur, kryeparlamentari Berisha e ka garantuar zotin Busek për vendosmërinë e Kuvendit dhe të institucioneve të tjera për bashkëpunim sa më të afërm me Paktin e Stabilitetit, me parlamentet dhe me institucionet tjera të Evropës.

Bashkëpunim gjithnjë në rritje drejt avancimit të proceseve aktuale në Kosovë

Marrëdhëniet miqësore ndërmjet Maqedonisë dhe Kosovës do ta lehtësojnë zgjidhjen e statusit final të Kosovës. -Përcaktimi i kufirit është çështje teknike, që do të zgjidhet me bisedime të dyanshme dhe nuk do të jetë problem serioz për avancimin e raporteve ndërmjet dy vendeve

Proceset aktuale politike, bashkëpunimi ndërmjet Kosovës dhe Maqedonisë, si dhe kontributi që japin shqiptarët e Maqedonisë në proceset e gjithmbarshme, sidomos kur është fjala për procesin e zgjidhjes së statusit të Kosovës, ishin çështje thelbësore të takimit të sotëm të kryetarit të Kuvendit të Kosovës, Kolë Berisha, me delegacionin e partisë së Bashkimit Demokratik për Integrim të Maqedonisë, të kryesuar nga Ali Ahmeti, kryetar.

Kryeparlamentari Berisha në prononcimin e tij para mediave shprehu mirënjohje për kontributin që jep BDI-ja në avancimin e proceseve në Kosovë. Ai tha se kjo parti dhe përgjithësisht shqiptarët e Maqedonisë, por edhe pjesa tjetër e popullit shqiptar në shtetet tjera, janë në rrjedha me zhvillimet e këtushme, duke ofruar

gjithnjë ndihmën e tyre të çmuar, sidomos tash kur është aktuale çështja e vendosjes së statusit të Kosovës. Kanë ndihmuar shumë dhe po kontribuojnë edhe sot, pra po bëhet një punë e përbashkët. Në këtë vështrim me BDI-në do të kemi kontakte edhe më të shpeshta për të thelluar bashkëpunimin.

Duke shkoqitur disa nga segmentet e bisedës gjatë takimit, Ali Ahmeti theksoi se është folur për ecuritë e Marrëveshjes së Ohrit, si dhe për avancimin e shumë nismave për avancimin e pozitës së shqiptarëve në Maqedoni. Edhe Ahmeti në plan të parë vuri çështjen e intensifikimit të bashkëpunimit të ndërsjellë, në këto ditë kur po zhvillohen punë jashtëzakonisht të rëndësishme rreth të ardhmes së Kosovës, posaçërisht të mbështetjes së pavarësisë së saj. Në këtë aspekt, premtoi Ahmeti, ndihma e

BDI-së dhe e shqiptarëve të Maqedonisë nuk do të mungojë. Ndërkaq, marrëdhëniet miqësore ndërmjet Maqedonisë dhe Kosovës do ta lehtësojnë zgjidhjen e statusit final të Kosovës. Përkritazi me pyetjen se çfarë mendoni për çështjen e përcaktimit të kufirit të Maqedonisë dhe Kosovës, Ahmeti u përgjigj se kjo është çështje teknike, që do të zgjidhet me bisedime të dyanshme dhe nuk do të jetë problem serioz për avancimin e raporteve ndërmjet Kosovës dhe Maqedonisë. Ai tha se në politikën e jashtme maqedone vërehen lëvizje mjaft pozitive, madje kjo nuk është meritë kryesisht jona, ky është fryt i asaj se popujt e rajonit ndiejnë nevojën për më shumë stabilitet dhe paqe. Në këtë frymë, ka edhe një avancim shtetëror maqedon në qëndrimin drejt zgjidhjes së statusit final të Kosovës.

Disa nene të Ligjit mbi Prokurimin Publik në Kosovë sjellin pengesa gjatë zbatimit në praktikë

Pritet që Qeveria e Kosovës së shpejti të miratojë një draft të ndryshimeve të këtij Ligji, i cili do t' i dërgohet Kuvendit për shqyrtim e miratim



Komisioni për Buxhet dhe Financa i Kuvendit të Kosovës, i kryesuar nga Naser Osmani, kryetar i Komisionit, mbajti sot një dëgjim publik lidhur me nevojën e amendamentimit të Ligjit mbi Prokurimin Publik në Kosovë (2003/17). Në këtë dëgjim merrnin pjesë edhe përfaqësues të Zyrës Ligjore të Kryeministrit, USAID-it, Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik, Agjencionit për Prokurim Publik etj. Një nismë e këtillë ishte ndërmarrë pas një vizite të këtij Komisioni në disa komuna të Kosovës, për të parë se me çfarë vështirësish ballafaqohen agjensitë kontraktuese me rastin e zbatimit të Ligjit për Prokurimin Publik në Kosovë, të shikuara këto edhe në dritën e një Raporti të auditimit që ishte bërë në këto agjensi. Ishte vërejtur se ka disa nene të këtij ligji të cilat sjellin pengesa gjatë zbatimit në praktikë, sidomos kur është fjala për procedurat kohore në tenderim, por edhe në segmente të tjera. Duke pasur parasysh të gjitha këto, u pa e arsyeshme që të organizohet një debat publik për të parë nëse është e arsyeshme amendamenti i këtij ligji.

Gjatë debatit u tha se ky ligj është mjaft i ndërlikuar, ashtu si edhe në gjithë botën, si kur është fjala për zgjidhjet që ofron, ashtu edhe për zbatimin e tij. Në këtë frymë shihej e arsyeshme të bëhet amendamenti i tij, në mënyrë që ai të jetë mundësisht sa më i thjeshtë, gjithë kjo në funksion të konkurrencës së mirëfilltë, kursimit ta parasë publike dhe të vënies së rregullave sa më të avancuara në pajtim me zgjidhjet më të mira që në këtë lëmë zbatohen në BE.

Në mbështetje të vrojtimeve e analizave të ekspertëve dhe disa institucioneve që veprojnë në Kosovë, tashmë një grup punues nga Qeveria e Kosovës kishte bërë një draft të ndryshimit të këtij Ligji. Pritet që Qeveria së shpejti edhe do të miratojë këtë draft, të cilin pastaj do t' ia dërgojë Kuvendit të Kosovës për procedurë të mëtejme të shqyrtimit dhe të miratimit. U theksua se në këtë aktivitet do të bashkëveprojë gjerësisht edhe Komisioni për Buxhet dhe Financa për të kontribuar në gjetjen e zgjidhjeve sa më të mira në ndryshimet që do të pësojë ky Ligj.

Botimi i teksteve alternative nuk duhet të vihet në dilemë

Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini e Sport i Kuvendit të Kosovës, i kryesuar nga Enver Hoxhaj, kryetar i Komisionit, mbajti sot një dëgjim publik lidhur me Projektligjin për botimin e teksteve shkollore, mjeteve mësimore, lektyrës shkollore dhe dokumentacionit pedagogjik. Në debatin mjaft të gjerë, pjesëmarrësit theksuan se ky Projekt paraqet një bazë shumë të mirë për të begatuar legjislacionin e vendit me një Ligj që rregullon një materie me interes në fushën e botimeve për nevoja të arsimit. Para të pranishmëve paraqitej një lloj dileme sa i përket çështjes se a duhet të kemi tekste alternative apo jo, athua mos është kjo ndonjë luks për rrethanat kosovare. Përkritazi me këtë, mbretëroi mendimi se së pari duhet të nisemi nga fakti që botimi i tekstit të përfillë kriteret e mirëfillta shkencore, didaktike e artistike. Nëse kjo arrihet, atëherë botimet hyjnë në konkurrencë dhe brenda pak vitesh tekstet më të mira do të përballojnë konkurrencën, përkatësisht do të hyjnë në përdorim të gjerë. Kjo është edhe një formë e thyerjes së monopoleve, përkatësisht e liberalizimit të tregut në këtë lëmë.

Edhe në këtë rast u bënë vërejtje sa i përket terminologjisë, e cila siç u tha, duhet të jetë e saktë dhe në pajtim me normën e gjuhës letrare.

Kornizë adekuate ligjore në funksion të zhvillimit të komunikacionit rrugor

Vërehen disa disa përzierje kompetencash ndërmjet ministrive përkatëse dhe pasaktësi në aspektin e terminologjisë, si dhe kundërshti ndërmjet disa neneve të këtij Projektligji me Ligjin aktual për Kundërvajtje të Kosovës, që do të reflektoheshin negativisht me rastin e zbatimit të këtij Ligji të ardhshëm

Projektligji për sigurinë në komunikacionin rrugor, i cili tashmë është miratuar në parim nga ana e Kuvendit të Kosovës, është i një rëndësie të veçantë. Ai ka peshë të madhe në ngritjen e nivelit të sigurisë në komunikacion, si dhe në zhvillimin e tij. Ky projekt synon një kornizë adekuate ligjore në funksion të zhvillimit të komunikacionit rrugor, në pajtim me standardet e Unionit Evropian, mirëpo për të qenë i tillë ai duhet të plotësohet edhe më, me zgjidhje sa më të mira e sa më precize në këtë fushë. Këto ishin disa nga konstatimet e dëgjimit publik të organizuar nga ana e Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion i Kuvendit të Kosovës, kryesuar nga Ibush Jonuzi, kryetar i Komisionit, lidhur me Projektligjin për sigurinë në komunikacionin rrugor. Në këtë mbledhje merrnin pjesë edhe Fatmir Rexhepi, ministër i Punëve të Brendshme të Kosovës, si dhe përfaqësues të Ministrisë së Transportit dhe

Telekomunikacionit. Në debatin shumë të gjerë e përmbajtësor u tha se ky Projektligj është e nevojshme t' i nënshtrohet një shqyrtimi të ngulmët, për të evituar çdo paqartësi. Në këtë vështrim duhet të mënjanohen disa pasaktësi në aspektin e terminologjisë, e cila nuk është sa duhet në pajtim me normat gjuhësore, ndërsa ndonjëherë nuk është e harmonizuar në tekstin e ligjit mjaft voluminoz. Vërehen edhe disa përzierje kompetencash ndërmjet Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Ministrisë së Transportit dhe Telekomunikacionit, të cilat duhet të evitohen. Ndër vërejtjet tjera ishin edhe ato që kishin të bëjnë me disa kundërshti që hasen ndërmjet disa neneve të këtij Projektligji me Ligjin aktual për Kundërvajtje të Kosovës, që do të reflektoheshin negativisht me rastin e zbatimit të këtij ligji të ardhshëm. Po kështu edhe shkalla e dënimeve nuk është e përcaktuar mirë sipas rrezikshmërisë në komunikacion, madje niveli i tyre është mjaft i lartë për standardin kosovar.

Zgjedhjet komunale me lista të hapura

Forumi i Zgjedhjeve prezanton para Komisionit Legjislativ Propozimrregulloren për zgjedhjet për kuvendet komunale. -Parashihet stimulim përfaqësimi për minoritetet dhe gratë

Anëtarët e Forumit të Zgjedhjeve kanë prezantuar sot para anëtarëve të Komisionit për Çështje Juridike, Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese Propozimrregulloren për zgjedhjet për kuvendet komunale dhe kanë dëgjuar vërejtjet e deputetëve për rregullativën e re për zgjedhjet.

E re është se zgjedhjet e ardhshme komunale do të bëhen me lista të hapura dhe me sistem proporcional.

Qytetarët do të kenë mundësi të votojnë partinë a koalicionin partiak, si dhe të votojnë një a më shumë kandidatë në listën zgjedhore të subjektit të dhënë zgjedhor. Fuqia e partisë do të varet nga votat që i merr subjekti përkatës, kurse votat e kandidatëve në atë listë do të shërbejnë për radhitjen e kandidatëve në përbërjen e asambleve komunale.

Propozimrregullorja e UNMIK-ut për zgjedhjet komunale parashih stimulim të veçantë përfaqësues për minoritetet dhe gratë. Kështu ,30 përqindëshi për gratë garantohet edhe nëse kandidatet nuk fitojnë numrin e mjaftueshëm të votave.

Megjithëse anëtarët e Komisionit Legjislativ rregullativën e propozuar për zgjedhjet komunale e kanë vlerësuar avancim serioz në planin e demokratizimit të procesit zgjedhor, kanë paraqitur vërejtje të shumta në përmbajtjen e kësaj rregulloreje.

Lidhur me zërat, ndërkaq, se mund të shtyhen zgjedhjet komunale për shkak të procesit të përcaktimit të statusit të Kosovës, kryetari i Komisionit, Hydajet Hyseni është shprehur: "Më mirë le të përshpejtohet përcaktimi i statusit të vendit, se sa të shtyhen zgjedhjet komunale, sepse kjo do të ishte një mesazh i keq për qytetarët tanë".

Komisioni Legjislativ, po në mbledhjen e sotme ka filluar shqyrtimin e Projektligjit kundër shpifjes.

Pavarësia e Kosovës do të prodhojë stabilitet dhe siguri në rajon

Kryetari Kuvendit të Kosovës, Kolë Berisha, bashkë me anëtarët e Kryesisë së Kuvendit të Kosovës, Sabri Hamiti, Xhavit Haliti, Ramë Buja, Naim Maloku dhe Gazmend Muhaxheri, të shoqëruar nga shefi i Misionit të Republikës së Shqipërisë në Kosovë, Bujar Muharremi, nga shtatë deri më nëntë prill 2006, kanë realizuar një vizitë të suksesshme në Shqipëri, me ftesë të kryeparlamentares Topalli.

Në takimin e parë të delegacionit parlamentar të Kosovës me kryetaren e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë znj. Jozenina Topalli, që u zhvillua në një atmosferë të ngrohët miqësore, kryetari i Kuvendit të Kosovës, z.Kolë Berisha, e njoftoi atë për zhvillimet fundin politike në Kosovë, për aktivitetin e Kuvendit të Kosovës në fushën legjislative, si dhe për bisedimet në Vjenë lidhur me zgjidhjen e statusit politik të Kosovës.

Qëndrim i përbashkët i subjekteve për Kosovën e Pavarur

Bisedimet e deritanishme në Vjenë kanë qenë të suksesshme për palën tonë, ngase kemi pasur iniciativë dhe oferta konkrete për temat që janë diskutuar, ka vlerësuar Berisha, kurse sa i përket statusit politik të Kosovës, ka sqaruar se ë gjitha forcat politike në Kuvend, të pozitës dhe të opozitës, kanë një qëndrim të përbashkët: Kosova e Pavarur - shtet demokratik, ku të gjithë qytetarët e saj do t'i gëzonin të drejtat dhe liritë e barabarta.

Ai ka pohuar tutje se decentralizimi dhe çështjet e tjera që do të bisedohen në Vjenë, do të zgjidhen (në pako) pas statusit të Kosovës, dhe do të sanksionohen me Kushtetutë dhe me ligje të tjera përcjellëse.

Topalli: do ta mbështesë Kosovën



Kryetarja e Kuvendit të Shqipërisë, znj. Jozefina Toppali, është shprehur qartë se Shqipëria, si në të kaluarën edhe në procesin e zgjidhjes së statusit politik, do ta mbështesë Kosovën, për ta fituar pavarësinë e saj të merituar.

Në takimin me kryeministrin Sali Berisha, delegacioni parlamentar i Kosovës u njoftua me masat që po ndërmerre Qeveria shqiptare për zgjidhjen e problemeve të brendshme të vendit.

Bashkëpunim në të gjitha fushat e jetës

Kryeministri Berisha është shprehur optimist se përpjekjet e kosovarëve,

të gjata dhe të mundimshme, në këtë vit, do të kurorëzohen e pavarësinë e Kosovës. Ai ka kërkuar të intensifikohet bashkëpunimi ndërmjet Kosovës dhe Shqipërisë, në të gjitha fushat e jetës, sidomos në fushën e arsimit, kulturës, tregtisë dhe turizmit.

Priotitet rrugës Durrës-Morinë

Ndër prioritetet e Qeverisë shqiptare gjatë këtij mandati, z. Berisha ka përmendur ndërtimin e rrugës Durrës-Morinë.

Qeveria shqiptare është shumë e interesuar për këtë rrugë, e cila mundëson zhvillimin e gjysmës së vendit (pjesën veriore), e cila një kohë të gjatë është lënë pas dore,



por edhe bashkëpunimin e Shqipërisë me Kosovës dhe rajonin. Në fund të takimit z. Berisha ka theksuar se Kosova do ta ketë mbështetjen e fuqishme të Qeverisë së Shqipërisë, që nëpërmjet procesit negociues, të realizojë vullnetin politik për një Kosovë të Pavarur.

Diplomacisa shqiptare në mbështje të zgjidhjes së statusit politik të Kosovës

Delegacioni i Kosovës pati takim edhe me ministrin e Punëve të Jashtme, z. Besnik Mustafaj, nga i cili u informuan për aktivitetet e diplomacisë shqiptare për ta mbështetur zgjidhjen e statusit politik të Kosovës, në përputhje me vullnetin politik të qytetarëve të saj. Ministri Mustafaj i informoi, në hollësi, anëtarët e Kryesisë për aktivitetin e tij dhe të diplomacisë shqiptare me përfaqësues të vendeve të ndryshme të botës, për ta fituar mbështetjen e tyre në zgjidhjen e drejtë të statusit të Kosovës. Në të gjitha takimet, me një përjashtim, janë shprehur qëndrime afirmative për zgjidhjen e statusit të Kosovës, ka pohuar Mustafaj.

Aktive, por jo aktore

Diplomacia shqiptare do të vazhdojë të jetë aktive, por jo aktor, në zgjidhjen e statusit të Kosovës. Po i shpjegojmë komunitetit ndërkombëtar se pavarësia e Kosovës do të prodhojë stabilitet dhe siguri në rajon, ka deklaruar, ndër të tjera Ministri i Jashtëm i Shqipërisë.

Takime me përfaqësues të partive opozitare

Gjatë vizitës zyrtare në Shqipëri delegacioni parlamentar i Kosovës është takuar edhe me përfaqësuesit e partive opozitare: Petro Koçi, Skender Gjinushi, Sabit Brokaj dhe Pirro Lutaj, me të cilët ka këmbyer mendime dhe përvoja parlamentare. Përfaqësuesit e partive opozitare

deklaruan se të gjitha partitë politike në Kuvendin e Shqipërisë kanë qëndrim të përbashkët - në mbështetje të pavarësisë së Kosovës.

Të mos ngritin tema që krijojnë tensione

Anëtarët e Kryesisë kërkuan nga partitë politike të Kuvendit të Shqipërisë, që në kohën kur po diskutohet për statusin e Kosovës, të mos ngritin temat që krijojnë tensione, ngase ato mund të kenë ndikime negative gjatë procesit negociues për status të Kosovës.

Pritje në Bashkinë e Durrësit

Ditën e fundit të qëndrimit në Shqipëri, Kryesia e Kuvendit është pritur edhe në Bashkinë e Durrësi, me ç'rast nga kreu i Bashkisë është njoftua për zhvillimin e këtij qyteti, përgatitjet për sezoni turistik, si dhe për kërkesat e kosovarëve, të cilët

pushimet verore planifikojnë t'i kalojnë në Durrës.

Me deputetët e zonës

Pas përfundimit të vizitave zyrtare, delegacioni Kuvendit të Kosovës ka vizituar Muzeun e Durrësit, si dhe ka pasur një drekë pune me deputetët e zonës së Durrësit dhe të Kavajës në Kuvendin e Shqipërisë. Në fund të vizitës, delegacioni i Kosovës ka falënderuar parlamentarët dhe qeveritarët shqiptarë për pritjen vëllazërore dhe për mbështetjen që po i japin Kosovës për zgjidhjen e statusit politik, në përputhje me vullnetin e qytetarëve të saj.

Me nderimet më larta ceremoniale

Delegacioni i Kosovës është pritur dhe përcjellë me nderimet më larta ceremoniale nga protokollin i shtetit. Foto dhe teksti: Sali Rexhepi



Kujtoheshin edhe vllimet e çastet e zhvillimit të parlamentarizmit në Shqipëri, të vënies së themeleve të shtetit modern shqiptar. Një ogur i bardhë në këto ngritje padyshim është edhe Legjislatura e Parë e vitit 1920. Pikërisht kjo fotografi e atij viti të largët, që rri krahas shumë pamjeve të tjera në hollin e Kuvendit të Shqipërisë, tërhiqte vëmendjen edhe me rastin e kësaj vizite.

Integriteti territorial i Kosovës dhe karakteri unitar i saj janë të pacenueshëm

Parimet e elaboruara për reformën e pushtetit lokal janë të vlefshme dhe mund të zbatohen në tërësi vetëm në Kosovën e pavarur dhe sovrane



Në bazë të propozimit të deputetit Emrush Xhemajli, të Grupit Parlamentar të AAK-së dhe të Komisionit për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Integritete Euroatlantike, Kryesia e Kuvendit kishte kërkuar që Grupi Negociator të raportojë në Kuvend, më 24 mars 2006, lidhur me dy takimet e zhvilluara në Vjenë. Lidhur me këtë, në këtë seancë të udhëhequr nga Kolë Berisha, kryetar i Kuvendit, para deputetëve foli zëvendëskryeministri Lutfi Haziri, i cili theksoi se vjen këtu me mandat të Delegacionit të Kosovës për status, apo të Ekipit të Unitetit. Vlerësimi që do të jap,

theksoi ai, nuk është vetëm imi, por është shprehur nga të gjithë anëtarët e Delegacionit dhe nga vëzhguesit e tjerë. Bisedimet deri më tash kanë qenë të suksesshme dhe janë në rrugë të mirë të krijojnë hapësirë, ambient politik, që Kosova të ecën drejt pavarësisë dhe rregullimit të statusit final. Por, po ashtu, kemi arsye të plotë, të themi se jemi të kënaqur me periudhën e deritashme dhe me padurim pres angazhimin tuaj që padyshim do të kontribuonte, që puna e delegacionit që unë e më vonë edhe z. Hashim Thaçi e kemi udhëhequr, të intensifikohet në të mirë të qytetarëve të vendit tonë.

Reformë nga e cila do të përfitojnë të gjithë qytetarët e Kosovës



Puna e delegacionit, vijoi Haziri, mbështetet në shumë dokumente dhe vendime që janë marrë nga Kuvendi i Kosovës. Me miratimin e po këtij Kuvendi sot dhe në bazë të dokumentit që është miratuar nga Kuvendi i Kosovës për parimet

themelore të pushtetit lokal në Kosovë, do të vazhdojmë të ecim drejt realizimit të këtyre objektivave. Po ashtu, ju garantoj se Delegacioni, me përkushtimin më të madh është në funksion të prezantimit të këtyre vendimeve dhe duke u mbështetur thellë në Rezolutën e Kuvendit të Kosovës të 17 nëntorit 2005. Më lejoni që t'i prezantoj edhe një herë disa nga parimet themelore të miratuara nga Delegacioni i Kosovës të datës 14 shkurt 2006. Parimet e elaboruara për reformën e pushtetit lokal janë të vlefshme dhe mund të zbatohen në tërësi vetëm në Kosovën e pavarur dhe sovranë. Cilat do diskutime për reformën e pushtetit lokal të mbështeten në premisën e zgjidhjes së statusit, në përputhje të plotë me vullnetin e popullit të Kosovës. Kosova angazhohet për një reformë të plotë të pushtetit lokal të udhëhequr sipas parimeve të efektivitetit, të funksionalitetit dhe të stabilitetit të saj, sipas të cilave do të përfitojnë të gjithë qytetarët e Kosovës, pavarësisht se cilit grup etnik i takojnë. Parimet për reformën e pushtetit lokal janë hartuar në përputhje me standardet e qeverisjes së mirë, të demokracisë, të transparencës e të sundimit të ligjit, ashtu siç janë të zbatueshme në mbarë Evropën sot. Parimet, po ashtu, pasurojnë vlerat mbizotëruese të dokumenteve më relevante ndërkombëtare në këto fusha, veçanërisht parimi i substidiaritetit të Bashkimit Evropian. Karta Evropiane për Vetëqeverisje Lokale dhe Korniza për Marrëveshjen e Ohrit si një nga plan modelet, është përmendur dhe, mbi të gjitha, dokumenti kornizë për reformën e pushtetit lokal që është diskutuar edhe në këtë Parlament. Reforma e pushtetit lokal në Kosovë duhet të sjellë vendimmarrje më të afërt për qytetarët, t'u ofrojë shërbime më të mira në nivel lokal, si dhe të sigurojë qeverisje të qëndrueshme dhe kushte të mira jete për

të gjithë ata. Gjithashtu kjo reformë duhet të kontribuojë në integrimin e të gjitha komuniteteve në strukturat demokratike të Kosovës. Të gjitha institucionet paralele ekzistuese duhet të shuhen dhe asnjë formë e re e institucioneve paralele jashtë kontrollit ekzekutiv të Kosovës, nuk do të tolerohet.

Integriteti territorial i Kosovës dhe karakteri unitar i saj janë të pacenueshëm, prandaj në mënyrë eksplicite përjashtohet çdo kërkesë me karakter territorial, siç janë: krijimi i korridoreve etnike, i enklavave, kërkesa territoriale që synojnë ndarje përgjatë linjave etnike, qoftë de jure apo de facto.

Para se t'ju njoftoj shkurtimisht për mbarëvajtjen e dy takimeve të para në Vjenë, më lejoni t'ju them edhe një fakt të rëndësishëm. Për ta prezantuar ofertën dhe pozicionet sipas parimeve të institucioneve të Kosovës për integrimin e pakicave në Kosovë, si dhe reformën e domosdoshme të pushtetit lokal për një të ardhme më të sigurt për të gjithë banorët, kemi marrë mandat të diskutojmë për temat që janë agjendë e vendosur nga përfaqësuesi i veçantë për status, z. Ahtisari dhe në asnjë mandat tjetër ky delegacion nuk ka autorizim të marrë pjesë në bisedime të drejtpërdrejta me ndërkombëtarë.

Më 16 shkurt, Delegacioni i Kosovës për Status merr mandatin që ta udhëheqë delegacionin për bisedimet e para në Vjenë, mandat i cili u konfirmua pas mandatimit të parë, që në reformën e pushtetit lokal të punojë dhe të angazhohet në emër të këtij organi, nga presidenti i ndjerë Rugova dhe Delegacioni i Kosovës, në dhjetor të vitit të kaluar. Takimi në Vjenë i mbajtur më 20 dhe 21 shkurt kishte për temë kompetencat që do t'i kenë komunat në të ardhmen. Në përputhshmëri me parimet e dokumentit kornizë të Qeverisë së Kosovës dhe me parimet që u përmendën si

substidiariteti dhe devoluimi i pushtetit, ne propozuam një sërë kompetencash të ndryshme, duke u fokusuar këtu edhe në kompetencat e fushës së arsimit, të shëndetësisë, kulturës, planifikimit urban, zhvillimit ekonomik lokal, rinisë, sportit dhe aktivitetet tjera. Po ashtu dëshiroj të theksoj se një pjesë e këtyre kompetencave në bazë të Rregullores 45 dhe legjislacionit në fuqi, në Kosovë janë e drejtë e komunave. Do të theksoj se propozimet e Kosovës nuk janë drejtuar në mënyrë selektive për komuna të veçanta, por vlejnjë për të gjitha komunat e tërë territorit të Kosovës. Angazhimet tona, me ndërmjetësimin e z. Rohan, që ka mandat të paraqesë ose të udhëheqë këto bisedime nga z. Ahtisari, kanë qenë të fokusuara në shëndetësinë primare dhe në atë sekondare, në mundësitë financiare, në nivelin qendror që ka kompetenca për udhëheqjen e koordinimit të përgjithshëm të politikave të shëndetësisë. Komunat të ofrojnë arsim parashkollor fillestar dhe sekondar, të drejtat gjuhësore, pra të drejtat për arsimim në gjuhën amtare, aty ku një grup etnik është pakicë. Komunat kanë përgjegjësi ta menaxhojnë arsimin dhe punësimin e arsimtarëve, duke përfshirë edhe pronën në arsim, serbët duhet ta kenë Universitetin në gjuhën e tyre, po ashtu edhe pakicat tjera duhet të vazhdojnë të kenë arsimim të lartë. Po ashtu, u diskutua edhe për disa kompetenca të komunave të sferës së aktivitetit kulturor, që të përfshihen teatrot komunale, aktivitete të ndryshme në kuadër të fushave që përfshijnë këto komuna. Të transferohet një pjesë e shërbimeve sociale në nivel komunash dhe, po ashtu, një nga diskutimet që është ndarë, ka të bëjë me çështjen e pensionistëve, që është larguar nga agjenda e pushtetit lokal.

Sa i përket policisë dhe drejtësisë, është arritur pajtimi që nuk mund të

ketë kompetenca komunale dhe që zinxhiri komandues të jetë i unifikuar, mirëpo policia në komuna dhe të punësuarit në sistemin juridik në Kosovë, reflektojnë përbërjen etnike të komuniteteve.

Po ashtu, propozim i Delegacionit të Kosovës është që të forcohet roli i komunës me emërimin e shefave lokalë të policisë, që i referohet parimit të Marrëveshjes së Ohrit, por që koordinohet apo është nën kushtin e vendimmarrjes të Ministrisë së Punëve të Brendshme, do të thosha se kjo është pjesa e parë e angazhimeve tona për takimin e parë.

Të gjitha donacionet nëpërmjet thesarit qendror

Ndërsa me vendim unanim të Delegacionit të Kosovës për status, z. **Hashim Thaçi** është emëruar udhëheqës i Delegacionit për bisedime në Vjenë që u zhvilluan më 17 mars.

Takimi ishte i fokusuar në financat lokale, në bashkëpunimin ndërkomunal dhe ndërkufitar. Delegacioni potencoi se lidhur me ndihmat financiare për komunat, në sferën e kompetencave përkatëse, Kosova është e hapur për donacione ndërkombëtare, duke inkuadruar këtu edhe ndihma nga shtetet fqinje, duke përfshirë edhe Serbinë. Të gjitha donacionet duhet të kalojnë nëpërmjet thesarit qendror dhe të jenë transparente, si dhe t'u nënshtrohen rregullave të përgjithshme të auditimit. Por, nuk mund të ketë ndërhyrje në institucionet financiare të Kosovës. Ne sqaruam se pajtohemi për krijimin e mekanizmave të bashkëpunimit ndërkomunal në të gjitha fushat e pushtetit lokal, mirëpo fuqimisht kemi potencuar se

këta mekanizma në asnjë mënyrë nuk duhet të shndërrohen dhe nuk bën të shndërrohen në nivel të tretë të pushtetit dhe në asnjë etnit të veçantë politik, as juridik. Konstatuam që bashkëpunimi ndërkomunal të rregullohet dhe të garantohet me kushtetutë dhe me Ligjin për qeverisjen lokale, që do të merrnin parasysh të gjitha standardet dhe përvojat më të mira evropiane dhe më gjerë. Interesimi i Serbisë për komunitetin serb në Kosovë është i drejtë, por institucionet e Kosovës këtë interesim do ta rregullojnë dhe sanksionojnë me marrëveshje bilaterale ndërmjet Kosovës dhe Serbisë dhe në asnjë formë tjetër.

Jemi të bindur se në secilin takim të bisedimeve jemi më afër Kosovës së lirë, demokratike, të pavarur dhe sovrane. Angazhimi ynë konkret, pa ngurrim, do të shtrojë të gjitha temat e caktuara nga z. Ahtisari, që kanë të bëjnë me reformën e pushtetit lokal, me trashëgiminë kulturore, me çështjet ekonomike dhe me ndarjen faktike. Është angazhim për ta afruar zgjidhjen e statusit në periudhë sa më të shkurtër. Të dy takimet e para ishin konstruktive dhe kanë ndihmuar të sqarohen pozicionet dhe të ngritet niveli i mirëkuptimit për disa çështje specifike. Konstatoj se dallimet diametralisht janë të kundërta në dokumentet që janë paraqitur para ndërmjetësuesit ndërkombëtar. Ndërsa, angazhimi ynë, në njërin anë është të vendosen parimi i funksionalitetit dhe i integritetit të komunitetit në institucionet e Kosovës, në anën tjetër, pala tjetër, paraqet dezintegrimin e komuniteteve dhe kërkon ndarjen e etniteteve, duke përfshirë edhe kërkesën për asimetri në qarqet e pushtetit lokal dhe kamuflojnë tendencat centraliste në emër të decentralizimit, duke vendosur komunitetin e saj etnik në një kontroll të qartë administrativ dhe politik për interesa që të ne janë të njohura.

Parimet e negociatave nuk kërkojnë që në këtë fazë të arrijmë marrëveshje për tema të veçanta. Marrëveshje e vetme është ajo që nuk ka marrëveshje për asnjë element të pakos pa zgjidhjen e statusit përfundimtar, deri sa nuk është arritur marrëveshja për pakon në tërësi. Kjo është formula që zoti Ahtisari e ka paraqitur dhe e ka konfirmuar edhe para delegacioneve tona. Detajet e diskutuara mund të zbatohen vetëm pasi të jetë arritur marrëveshja rreth Kosovës së pavarur dhe sovrane. Asgjë nuk mund ta ndalë Kosovën drejt lirisë së plotë për të gjithë qytetarët e saj dhe, po ashtu, reforma e pushtetit lokal në Kosovë, si pjesë e procesit të institucioneve të Kosovës, vazhdon të trajtohet në të gjitha ato segmente, që nuk janë pjesë e statusit as e negociatave.

Ndërmjetësuesi ndërkombëtar po i bën presion kryesisht viktimës

Emrush Xhemali mbështeti përpjekjet për një Kosovë të shkëputur nga Serbia, të aftë ta qeverisë vetveten në nivel qendror dhe lokal dhe në bashkëpunim me bashkësinë ndërkombëtare të arrijmë atje ku jemi nisur. Në Kosovë askush nuk mendon të shkojë në Evropë me disa robër që nuk guxojnë të lëvizin në Kosovë dhe as me qytetarë të rendeve të ndryshme dhe të diskriminuar, por të jenë të gjithë të barabartë para ligjit. I përshëndes përpjekjet e Grupit të Kosovës për Statusin dhe për atë që tha zoti Haziri. Sa është i suksesshëm ky do të shihet në fund. Është përgjegjësi e madhe dhe e di që nuk është e lehtë pozita e grupit



tonë. Pozita e vështirë e grupit buron nga statusi i paqartë i vendit, i mbajtur me premtime se do të bëhet mirë, përballë palës serbe të mbështetur nga struktura shtetërore e saj, e njohur ndërkombëtarisht. Përsëri diskutohet vetëm fati i viktimës, i Kosovës, ndërkaq fati i agresorit mbetet i garantuar, i pacenuar dhe i padiskutueshëm. Të gjithë po e shohim se Serbia, aq sa ka fuqi pa mëshirë po punon për ta dëmtuar vendin tonë. Të gjithë po e shohim se ndërmjetësuesi ndërkombëtar po i bën presion kryesisht viktimës, ndërsa agresorit po i bëhen favore të njëpasnjëshme dhe si rrjedhim Delegacioni ynë e ka pasur dhe do ta ketë edhe më vështirë në të ardhmen.

Delegacioni i Kosovës, tha në vijim Xhemajli, nuk i është përmbajtur mandatit që i ka dhënë ky Kuvend në disa drejtime. Në këtë mandat nuk përfshihen bisedimet për çështjen e organizimit të brendshëm të Kosovës, siç është riorganizimi i pushtetit lokal për territorin e Kosovës, ende pa asnjë garanci zyrtare për statusin e pushtetit qendror të vendit. Delegacioni i Kosovës nuk ka sqaruar organizatorin se ndjehet dhe është i pabarabartë dhe nën presion të paarsyeshëm në këto bisedime.

Përfshirje e qytetarëve në vendimmarrje, ofrim shërbimesh më të efektshme



Shefja Grupit Parlamentar të AAK-së, **Gjylnaze Syla** për krahu Ekipin e Unitetit për dokumentin dhe strategjinë

e tij lidhur me çështjen e reformës së pushtetit lokal. Konsiderojmë se reforma e pushtetit lokal është një proces i domosdoshëm dhe i

dobishëm në Kosovë, për afrimin e pushtetit të qytetari, për përfshirjen e qytetarëve në vendimmarrje dhe për ofrimin e shërbimeve më të efektshme për qytetarët e Kosovës, tha ajo. Grupi Parlamentar i AAK-së nuk mendon se nëpërmjet reformës së pushtetit lokal arrihet copëzimi ose kantonizimi i Kosovës, ngase koncepti i ofruar nga Qeveria dhe nga Ekipi i Unitetit nuk lejon këtë. Për fat të mirë, për këtë ekziston pajtimi i pozitës dhe i opozitës. Megjithatë, për hir të sinqeritetit ndaj qytetarëve të Kosovës duhet ta bëjë të qartë edhe një të vërtetë se reforma e pushtetit lokal, përveç aspekteve të qeverisjes së mirë dhe efektive, si dhe të afrimit të pushtetit qytetarëve, në vete përfshin edhe aspektin minoritar, duke u ofruar minoriteteve në Kosovë të drejta më të zgjeruara në fushën e arsimit, të shëndetësisë dhe të kulturës. Gjithashtu, është e vërtetë se kemi konkluduar se reforma e pushtetit lokal do të ishte shumë më e suksesshme dhe më e lehtë për ne sikur të bëhej pas përcaktimit të statusit të Kosovës. Megjithatë, bashkësia ndërkombëtare ka kërkuar prej nesh, ta quaj ashtu, paradhënie, pra dëshmi se ne do të jemi në gjendje të garantojmë të drejtat e minoriteteve pas statusit. Jam e bindur se Kosova do ta kalojë këtë test dhe do të dëshmojë se është e përgjegjshme për mbrojtjen e të drejtave të minoriteteve, duke mos pranuar me asnjë kusht korridore që mund t'i lidhin enklavat serbe ndërmjet tyre në Kosovë.

Gjylnaze Syla apeloj tek Ekipi i Unitetit dhe te Qeveria që në këtë proces nëpërmjet z. Ahtisarit t'ua bëjë të qartë bashkësisë ndërkombëtare dhe Qeverisë së Serbisë, se në Kosovë nuk ka decentralizim pa garanci paraprake se të gjitha territoret e Kosovës do të vihen nën kontrollin dhe autoritetin e Qeverisë së Kosovës dhe të UNMIK-ut që e ka këtë mandat.

Disiplinim shtetëror i përfaqësimit dhe i veprimit politik shtetëror



Kryetari i Komisionit Parlamentar për Bashkëpunim Ndërkombëtar, **Sabri Hamiti**, shprehu bindjen se ky bisedim në Kuvend

është i domosdoshëm, se ky është vetëm fillimi dhe se sot as që do t'i shteren të gjitha interesimet, as që do të vendoset diçka e veçantë. Interesimi ynë ka qenë që njëherë e përgjithmonë njerëzit që mandatohen në këtë Kuvend, t'i marrin përgjegjësitë e veta para mandatorit, ose në Kuvend dhe nën dy - të krijohet një përgjegjësi politike dhe përfaqësuese, që unë nuk ngurroj ta quaj disiplinim shtetëror i përfaqësimit dhe i veprimit politik shtetëror. Këtu ne kishim një paraqitje në emër të Grupit Negociator, por dy tri-ditë më parë kemi pasur një raportim para komisionit tonë dhe në këtë kuptim e falënderoj z. Lutfi Haziri, zëvendëskryeministër i Kosovës, që ka raportuar edhe atje, mirëpo ai shtroi pyetjen pse nuk është këtu edhe Hashim Thaçi. Kjo, theksoi Hamiti, është papërgjegjësi. Ajo që na intereson sot në këtë fazë të bisedimeve, është pak a shumë, për çka bisedohet atje, për çka është biseduar deri më tash dhe çka do të bisedohet tutje? Për çka bisedohet, artikulumet janë të ndryshme, ne e themi të gjithë se bisedohet për pranimin ndërkombëtar të Kosovës dhe ne mandat tjetër në Kuvend edhe nuk kemi dhe ata që ne i kemi mandatarë për bisedime, sa e di unë nuk kanë mandat tjetër, se i nënshtrohen një Rezolute të Kuvendit të Kosovës, që i obligon dhe që vetë e kanë marrë parasysh, se do ta kenë

moto të punës së tyre çështjen e pavarësisë së Kosovës. Kjo që themi ne rruga ndërkombëtare e pranimit të Kosovës, që është fraza lapidare e presidentit Rugova, ka të bëjë me këtë rrjedhë që ne e quajmë politikë diplomatike të pavarësisë. Sa i përket deklarimit ne e kemi bërë deklarimin, edhe me referendum, edhe në Kuvend dhe nuk ka mbetur shumë retorikë rreth kësaj.

Ekipi ynë thotë që për të arritur atje bashkë me miqtë tanë ndërkombëtarë ose me Ekipin Ndërkombëtar të bisedimeve duhet të krijohet pakoja paraprake, që ne i themi pakoja e pavarësisë së Kosovës, ku duhet të bisedohen një mori temash që në të vërtetë janë rregullim sistemor i brendshëm i Kosovës. Po e them paraprakisht se nuk është shumë i thjeshtë, nuk është kaq i thjeshtë dhe kaq i butë qysh e paraqiti z. Haziri këtu, nuk është i thjeshtë dhe i butë, siç e propagandojnë në takimet jointucionale publike ekipet negociatore, ne i kemi dëgjuar nëpër gazeta, nëpër grupe të shoqërisë civile, të partive të veta etj. Problemi është shumë më i thellë. Problemi që e kemi në diskutim është decentralizimi. Dikush i thotë më butë reforma e pushtetit lokal për t'iu ofruar pushteti lokal më afër qytetarit, që është më moderne të thuhet. Me kohë kam thënë në këto banka të Kuvendit edhe vitin e kaluar, decentralizim do të thotë ta kesh njëfarë qendre diku të pushtetit, Kosova ende nuk ka qendër të pushtetit. Ky është problemi, sepse organet e përkohshme të Kosovës kanë gjysmë pushteti, ose çerek pushteti real me Kornizën Kushtetuese. Çka po decentralizojmë? Çka kemi ne që do t'u jepet komunave? Pra, ne kemi një shkallorë të ndërtimit të brendshëm në këto bisedime pa u deklaruar, një rrjet i krijimit të pushtetit të parë lokal. Ky është problem sistemor, në esencë ne kemi një bisedë për decentralizimin që e ka nën një - problemin e pakicave, për ta bërë

më të qartë problemin e pakicës serbe. Ajo që është biseduar deri më tash substancialisht është biseduar, si do të duket gjendja e pakicës serbe në Kosovë nesër ose sot. Kjo është esenciale dhe këtë deputetët duhet ta dinë dhe duhet ta dinë edhe qytetarët. Enklavat serbe nuk janë zgjidhje, zgjidhje është integrimi. Enklavizimi edhe po të shpallet si xhenet, një parajsë e rrethuar me mure nga të tjerët nuk thotë asgjë, është një ferr dhe kjo duhet të kihet parasysh.

Grupi i Unitetit ta ketë një rregullore të punës dhe të funksionimit

Jakup Krasniqi, shef i Grupi



Parlamentar të PDK-së theksoi se përfundimi i këtyre bisedimeve do të jetë mbi bazën e vullnetit të shumicës, përndryshe ky proces nuk do të kishte kuptim. Fillimisht e shoh të nevojshme të them se këtu kemi një mangësi të madhe. Grupi i Unitetit, që shpeshherë po e quajmë Grup Negociator, nuk ka rregullore të punës e cila do t'i ndërtonte disa raporte ndërmjet këtij grupi, që është zgjedhur në Parlament dhe Parlamentit, por edhe institucioneve tjera që kanë dalë nga vota e lirë e qytetarëve. Është e pakuptimtë që ne të bisedojmë për një raport të Grupit të Unitetit, kurse Grupi nuk është prezent në këtë sallë. Ne jemi të bindur se ky Parlament ka zgjedhur Grupin e Unitetit dhe vetëm ky grup e ka të drejtën legjitime për të raportuar para Kuvendit për çështjen e bisedimeve në Vjenë. Unë në parim pajtohem me fjalën e deputetit dhe kryetarit të Komisionit për Bashkëpunim Ndërkombëtar, z. Sabri Hamiti, por vërtet kur dëshiro-

jmë të jemi parimorë është mirë që edhe ai të kërkojë që Grupi i Unitetit ta ketë një rregullore të punës dhe të funksionimit të tij dhe që grupi, ose më mirë të thuhet udhëheqësi i grupit, që njëkohësisht është kryetar i Kosovës, t'i raportonte Kuvendit se çka është arritur në këto bisedime deri më tani. Me gjithë atë janë disa vërejtje që në të ardhmen Grupi i Unitetit duhet t'i heqë nga rendi i ditës, për ndryshe nuk është mirë që ekspertë ose pjesëtarë të tjerë të delegacioneve që nuk janë votuar në këtë Parlament, të raportojnë për një çështje ndër më substancialet që është për Parlamentin, për institucionet dhe për qytetarët e Kosovës. Mendoj që raportuesi dhe Grupi i Unitetit, së paku në këtë Parlament, të tregojë diçka që është e vërtetë. E vërteta është se në Vjenë nuk po bisedohet për reformën e pushtetit vendor, as për decentralizimin. Në Vjenë po bisedohet vetëm për një pjesë të decentralizimit, se çka institucionet e Kosovës u ofrojnë jo shumicës, por pakicës serbe dhe ndoshta vetëm në këtë raport ka kuptim që Delegacioni i Kosovës të bisedojë në Vjenë me palën serbe, me ndërmjetësimin e faktorit ndërkombëtar, përndryshe reformimi i pushtetit vendor dhe decentralizimi janë çështje të Kosovës, të shtetit të pavarur dhe sovran të Kosovës në të ardhmen. Prandaj, do të ishte mirë që edhe vetes t'i themi se këto bisedime po bëhen për palën serbe dhe për interesin e tyre. Duke qenë vetë një nga anëtarët e grupit politik, që kemi përgjegjësinë për përgatitjen e dokumenteve për Grupin e Unitetit, dua të them se ndoshta do të duhej që Grupi i Unitetit, së paku dokumentet që janë dorëzuar në Vjenë, t'i ishin dorëzuar edhe Parlamentit e dhe deputetëve të këtij Kuvendi. Kjo nuk ka ndodhur. E dyta, nuk është shqetësuese ajo që është përgatitur për t'u përgjigjur, por disa pyetje që janë bërë në atë dokument, për të cilin është biseduar në Vjenë.

Pyetjet janë shqetësuese, jo materiali që është shkruar dhe është miratuar nga Grupi i Unitetit, por pyetjet në një formë ose një tjetër tregojnë se në të ardhmen për çka do të bisedohet edhe nga mund të shkojë rrjedha në bisedimet e ardhshme.

Numan Baliq, duke folur në emër të Grupit për integrim, theksoi se ne dëshirojmë të japim kontributin tonë të plotë në bisedimet për statusin e ardhshëm të Kosovës. Në grupin tonë, në kuadër të këtyre komuniteteve dhe partive, ekziston një disponim unik për përkrahjen e të gjitha proceseve negociuese që janë në vazhdim e sipër, përkatësisht që të marrim pjesë në këto negociata. Pra, ne kërkojmë vendin tonë, duam që të jemi të barabartë në procesin e marrëveshjes; kemi të bëjmë me minoritetet e integruara: boshnjakët, romët, turqit, egjiptasit, hashkalinjtë. Çështja për të cilën po debatohet është ekskluzivisht çështje e pakicave; natyrisht, ne e dimë se do të duhej që decentralizimi të shqyrtohej si nga aspekti gjeografik dhe kulturor, ashtu edhe nga ai funksional dhe aspekte të tjera, mirëpo, është fare e qartë dhe as që mund t'i shmangemi dhe ta fshehim presionin e bashkësisë ndërkombëtare që sistemi i decentralizimit të merret, para së gjithash, si çështje ekskluzive e pakicave; nuk është aspak me vend që çështjet që u përkasin pakicave dhe vetë pakicat të injorohen. Unë pyes: në interesin e kujt është që të injorohen këto komunitete; a është në interesin e Kosovës që të injorohen turqit, romët, boshnjakët dhe ata që tashmë janë integruar në shoqërinë kosovare? Ne ofrojmë kontributin tonë, kërkojmë një qëndrim të ndershëm,



të Grupit për integrim, theksoi se ne dëshirojmë të japim kontributin tonë të plotë në bisedimet për statusin e ardhshëm të

Kosovës. Në grupin tonë, në kuadër të këtyre komuniteteve dhe partive, ekziston një disponim unik për përkrahjen e të gjitha proceseve negociuese që janë në vazhdim e sipër, përkatësisht që të marrim pjesë në këto negociata. Pra, ne kërkojmë vendin tonë, duam që të jemi të barabartë në procesin e marrëveshjes; kemi të bëjmë me minoritetet e integruara: boshnjakët, romët, turqit, egjiptasit, hashkalinjtë. Çështja për të cilën po debatohet është ekskluzivisht çështje e pakicave; natyrisht, ne e dimë se do të duhej që decentralizimi të shqyrtohej si nga aspekti gjeografik dhe kulturor, ashtu edhe nga ai funksional dhe aspekte të tjera, mirëpo, është fare e qartë dhe as që mund t'i shmangemi dhe ta fshehim presionin e bashkësisë ndërkombëtare që sistemi i decentralizimit të merret, para së gjithash, si çështje ekskluzive e pakicave; nuk është aspak me vend që çështjet që u përkasin pakicave dhe vetë pakicat të injorohen. Unë pyes: në interesin e kujt është që të injorohen këto komunitete; a është në interesin e Kosovës që të injorohen turqit, romët, boshnjakët dhe ata që tashmë janë integruar në shoqërinë kosovare? Ne ofrojmë kontributin tonë, kërkojmë një qëndrim të ndershëm,

kërkojmë që personi që do të shkojë - të përfaqësojë të gjitha komunitetet, të jetë prej nesh dhe t'i përfaqësojë të gjitha interesat tona, e jo që të na imponohet ndonjë sistem i manipulimeve, që nuk është i mirë as për Kosovën, as për ne.

Xhezair Murati, në emër të Grupit 6+, theksoi se ky grup përshëndet unitetin e Ekipit Negociator të Kosovës, ndërsa në vijim tha se disponon një dokument, që është lëshuar më 2 mars në Strasburg, ndërsa parashikohet që të aplikohet konventa-kornizë për mbrojtjen e pakicave në Kosovë; në te, në mënyrë të hollësishme, është bërë analiza se si janë duke u realizuar këto të drejta të pakicave në Kosovë, duke përfshirë një konstatim që, si bashkësia ndërkombëtare, ashtu edhe ne këtu, shpesh merremi me të drejtat e pakicës serbe, kurse shpesh i lëmë anash apo i anashkalojmë të drejtat e atyre komuniteteve që të gjithë i quajmë si komunitete të integruara.



në emër të Grupit 6+, theksoi se ky grup përshëndet unitetin e Ekipit Negociator të Kosovës, ndërsa në vijim tha se disponon një dokument, që është lëshuar

më 2 mars në Strasburg, ndërsa parashikohet që të aplikohet konventa-kornizë për mbrojtjen e pakicave në Kosovë; në te, në mënyrë të hollësishme, është bërë analiza se si janë duke u realizuar këto të drejta të pakicave në Kosovë, duke përfshirë një konstatim që, si bashkësia ndërkombëtare, ashtu edhe ne këtu, shpesh merremi me të drejtat e pakicës serbe, kurse shpesh i lëmë anash apo i anashkalojmë të drejtat e atyre komuniteteve që të gjithë i quajmë si komunitete të integruara.

Teuta Sahatqija, shefe e Grupit parlamentar të partisë reformiste Ora theksoi se temat që janë shtjelluar në takimin e parë dhe në takimin e dytë janë konkrete. Synohet të arrihet një qasje pozitive kur është fjala për decentralizimin, që qytetari të ketë një qasje dhe një jetë më të mirë. Mendojmë që delegacionet tona janë të përfaqësuara si duhet dhe kemi besim në kapacitetet e tyre, duke pasur parasysh që edhe Grupi Negociator që e kemi zgjedhur në



theksoi se temat që janë shtjelluar në takimin e parë dhe në takimin e dytë janë konkrete. Synohet të arrihet një qasje pozitive kur është fjala për

decentralizimin, që qytetari të ketë një qasje dhe një jetë më të mirë. Mendojmë që delegacionet tona janë të përfaqësuara si duhet dhe kemi besim në kapacitetet e tyre, duke pasur parasysh që edhe Grupi Negociator që e kemi zgjedhur në

Parlament, e ka fituar përkrahjen e Parlamentit, që është në gjendje t'i zgjedhë përfaqësuesit që do të bisedojnë për statusin. Sa u përket komuniteteve unë nuk do të hyja në detaje dhe nuk do të përgjigjesha në këtë, por mendoj që pakicat jo serbe janë të përfaqësuara dhe si do të jetë përfaqësimi i tyre dhe kush do t'i përfaqësojë ata në Grupin Negociator dhe a do të dëgjohet zëri i tyre, mendoj së është një çështje e brendshme, që duhet ta zgjidhin ata në këshillin konsultativ.

Ramadan Kelmendi tha se negociatat për decentralizim kanë filluar me Mitrovicën e ndarë, me shumë probleme të hapura për të cilat nuk shihet zgjidhje adekuate, reale dhe juridike. Grupi i Negociatave nuk e ka prezantuar strategjinë për procesin e integrit të Mitrovicës.

Mahir Jagicar theksoi se gjatë procesit të bisedimeve për ne është zgjidhje logjike që kërkesat që i kemi, të ketë mundësi që të njëjtat t'ia



proponojmë Ekipit të unitetit dhe lidhur me pranueshmërinë e këtyre kërkesave të diskutohet në grupet kompetente për bisedime, para se dokumenti përkatës të miratohet dhe të propozohet për bisedime në Vjenë. Mendoj se përfaqësuesit e bashkësive tona në Vjenë duhet të jenë vetëm mbrojtës të qëndrimit të përbashkët të Ekipit të Kosovës, kurse këtu në Kuvend, para ekipit negociues ose para forumit konsultativ, duhet të mbrojmë kërkesat e bashkësive tona. Në rastin konkret, ne dokumentin e decentralizimit kamë vërejtje lidhur me përdorimin e gjuhës në nivelin lokal, që është kufizuar në 5%. Mendoj se, që në bazë të qëndrimit të arritur më parë, nga kufizimi

proponojmë Ekipit të unitetit dhe lidhur me pranueshmërinë e këtyre kërkesave të diskutohet në grupet kompetente për bisedime, para se dokumenti përkatës të miratohet dhe të propozohet për bisedime në Vjenë. Mendoj se përfaqësuesit e bashkësive tona në Vjenë duhet të jenë vetëm mbrojtës të qëndrimit të përbashkët të Ekipit të Kosovës, kurse këtu në Kuvend, para ekipit negociues ose para forumit konsultativ, duhet të mbrojmë kërkesat e bashkësive tona. Në rastin konkret, ne dokumentin e decentralizimit kamë vërejtje lidhur me përdorimin e gjuhës në nivelin lokal, që është kufizuar në 5%. Mendoj se, që në bazë të qëndrimit të arritur më parë, nga kufizimi

prej 5% të përjashtohet gjuha turke si një gjuhë historike dhe tradicionale në Kosovë. Lidhur me këtë e kemi njoftuar Forumin konsultativ, por nuk kemi marrë përgjigje përkatëse. Gjithashtu për çështjet e kufijve të komunave dhe të formimit të komunave të reja nuk kemi marrë përgjigje. Prandaj edhe një herë potencojë që rreth disa çështjeve të ndjeshme dhe interesave vitale për bashkësitë duhet që qëndrimet të përputhen para se dokumenti të pranohet nga ana e Ekipit negociues. Që të arrihet një unitet i plotë edhe me bashkësitë e tjera është shumë e rëndësishme që edhe një herë ta potencojë domosdoshmërinë që në të gjitha ekipet dhe grupet të përfshihen përfaqësuesit e bashkësive edhe në fazën e përgatitjes edhe në fazën e miratimit të dokumenteve për negociata. Veçanërisht kjo është e rëndësishme kur është fjala për hartimin e dokumentit kushtetues, kështu që në hartimin e Kushtetutës gjithsesi duhet të marrin pjesë edhe ekspertët tonë.

Të nderuar deputetë, gjatë kësaj jave ne si forum konsultativ do ta kemi një tryezë të rrumbullakët lidhur me këtë çështje dhe shpresoj se do të arrijmë të hartojmë platformën dhe metodën e përbashkët për paraqitje në dokumente dhe ne ekipe për bisedime dhe kështu do t'iu përgjigjemi kërkesave të bashkësive tona dhe të gjithëve do t'ua lehtësojmë punën.

Në fund , edhe një herë e përsërisht gatishmërinë për veprim dhe punë të përbashkët të të gjithë pjesëmarrësve të anës kosovare për bisedime dhe shpresoj se në të ardhmen të gjitha këto kërkesa dhe shqetësimet tona të merren parasysh me kohë dhe të zgjidhen në mënyrë pozitive. Gjithashtu, e përsërisht debatin lidhur me këtë çështje jetike për të gjithë ne që

jetojmë në Kosovë, me shpresë që kjo praktikë në Kuvend dhe në forumet tjera edhe më tutje të vazhdojë.

Sabit Rrahmani u angazhua për



një përfaqësim më të mirë të komuniteteve joserbe në grupet punuese dhe në delegacionin e Vjenës.

Xhavit Haliti theksoi se fakti që jemi këtu dhe po flasim për këtë çështje duhet të shihet e ndërlidhur me disa faktorë, siç është Lufta Çlirimtare e



Kosovës dhe në v e ç a n t i angazhimi i gjithë njerëzve për të luftuar për jetën dhe për Kosovën. Realisht ne kemi një deklaram publik


të hapur të Bashkësisë Ndërkombëtare që Kosova duhet të jetë e pavarur dhe unë nuk di pse po u dashka tash të merremi me atë se a do të na njohin apo jo, a do të kemi Kosovë të pavarur me kushte apo pa kushte. Kosova duhet të jetë e pavarur, e kanë thënë këtë edhe ata që mund të vendosin, anëtarë të Këshillit të Sigurimit, ndërsa asnjëri nga këto grupe që kanë qenë në Vjenë nuk i kanë lapsat që do të mund të nënshkruanin atë punë, këto janë grupe teknike për problemet për të cilat kanë shkuar të bisedojnë dhe njërin e ka kryesuar një herë zëvendëskryeministri Lutfi Haziri dhe tjetrin e ka kryesuar kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës dhe anëtar i Ekipit të Unitetit, z. Hashim Thaçi.

Sot nuk është Kosova në pazar dhe nuk është një thes me flori, as nuk është një thes me drithë , të cilin mund ta shesë as njëri e as tjetri

politikan. Dhe kjo nuk i lejohet dhe s'do t'i lejohet askujt.

Në vijim ai tha se meqë kemi formuar Ministrinë e Brendshme do të ishte e udhës që z. ministër i Brendshëm para se ta marrë detyrën të na referonte një program ose një plan i cili përmes këtij parlamenti do t'i garantonte Bashkësisë Ndërkombëtare dhe bashkësisë serbe në Kosovë, cili është plani i kësaj Ministrie për ta ndërtuar sigurimin ose sigurinë e qytetarëve, të cilët po e konsiderojnë veten të rrezikuar, cilat përgjegjësi do t'i marrë kjo Ministri dhe nuk kemi pse të frikësohemi që ne ato përgjegjësi duhet t'i marrim. Cila është përgjegjësia e kësaj Ministrie dhe e Policisë së Kosovës për t'i ruajtur dhe për t'i garantuar kishat serbe, të cilat duhet t'i garantojmë ne dhe jo dikush tjetër nga jashtë.

Alush Gashi theksoi se gjatë



debatit, në veçanti të anëtarëve nga Grupi parlamentar i LDK-së ka pasur përpjekje që të jepen propozime për zgjidhje të qëndrueshme të çështjes së Kosovës.

Me këtë rast në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, i cili grup e ka për detyrë dhe objektiv ta zbatojë politikën e Lidhjes Demokratike të Kosovës dhe programin e saj zgjedhor ju rikonfirmoj se Lidhja Demokratike e Kosovës nëpërmjet Grupit të vet parlamentar në Kuvendin e Kosovës e mbështet qëndrimin e Grupit të Kontaktit për mos ndryshim të kufijve të Kosovës.

Diskutimet edhe sugjerimet individuale nga radhët e grupit tonë, të merren si qëndrime individuale. Qëndrimi politik i LDK-së dhe i Grupit Parlamentar është pacenueshmëria e kufijve të Kosovës.

